



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë
Bachelor “Gjuhë -Letërsi”
i
Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


Prof.As. Monika Hasani

Dr. Elida Bega

Mars 2022

Për Programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Shqipe dhe Letërsi” ofruar nga Universiteti “Fan Noli”, Korçë

Nr.		
1.	IAL aplikues:	Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë
2.	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë
3.	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Gjuhë- Letërsi”, (Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë)
4.	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM nr.423, datë 08.06.2011
5.	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6.	Regjistrimi i formës së diplomës:	UMAS Nr. 323, datë 05.06.2017
7.	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8.	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9.	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite /6 semestra
10.	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11.	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12.	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13.	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14.	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15.	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16.	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17.	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	16 PAE/3 PAK
18.	Numri i studentëve:	16 studentë (cikël i plotë studimesh)
19.	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Më 08 dhe 09 nëntor 2021, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm zhvilloi vizitën në Universitetin “Fan S. Noli” në Korçë për vlerësimin e programit të studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Gjuhë dhe Letërsi”. Vlerësimi i këtij programi studimi bëhet për herë të parë nga ASCAL-i.

Për të kryer vlerësimin e programit të studimit GVJ u mbështet në RVB-në, bashkëshoqëruar me dokumentacionin përkatës, si dhe në takimet me të gjithë aktorët përgjegjës për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e këtij program studimi.


Përgjithsisht mund të themi se është bërë një punë e përgjegjshme për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë, për grumbullimin e të dhënave të bollshme në shërbim të vlerësimit për akreditimin e programit. Ky aplikim është përvoja e parë për këtë departament që mbulon programin e studimit. RVB-ja është ndërtuar në frymë kolegjiale, me objektivitet dhe qartësi dhe me përpjekje që të pasqyrohet me vërtetësi, gjendja aktuale e cilësisë së programit të studimit, e stafit akademik dhe atij administrativ, si dhe e infrastrukturës mbështetëse. RVB-ja është ndërtuar duke përdorur burime të nevojshme, duke e mbështetur çdo pohim në shkresën përkatëse që disponon DGJL, si dhe duke përdorur drejt terminologjinë e fushës së vlerësimit të cilësisë.

Programi i studimit është hartuar dhe zbatohet në përputhje me kërkesat e Ligjit të AL 80/2015, të akteve nënligjore dhe të urdhrave e rekomandimeve të Senatit Akademik dhe Rektoratit të UK “Fan S. Noli”.

Disiplinat gjuhësore dhe letrare që përbëjnë këtë program studimi janë planifikuar të ndara me silabuse dhe ngarkesa në ETCS. GVJ vëren se ka vend ende për përmirësim, veçanërisht të raportit të ngarkesës midis disiplinave të formimit bazë dhe disiplinave të tjera. Gjithashtu duhet riparë ngarkesa për disa pedagogë, të cilët mbulojnë njëherazi disiplina jo të së njëjtës natyrë, apo të afërta.

DGJL në Universitetin e Korçës ka në përbërje staf akademik me përvojë dhe të kualifikuar që i përballon shumë mirë kërkesat shkencore që shtron ky program studimi. GVJ-ja vërejt se stafit akademik duhet të jetë më i shtuar, në përmbushje të realizimit të programeve që departamenti ofron. Stafit akademik i departamentit duhet të përfshihet më shumë në projekte e trajnime ndërkombëtare, si dhe duhet të punojë më shumë për ndërkombëtarizimin e departamentit. Sfidat më të madhe që duhet të zgjidhë në të ardhmen ky departament është tërheqja e më shumë studentëve në këtë program studimi. Aktualisht ka vetëm 6 studentë në vitin e parë parë, të regjistruar për vitin 2021-2022, për vitin 2020-2021, 7 studentë, dhe për vitin 2019-2020, 3 studentë. Ky është një problem, i cili ndërthur shumë arsye dhe aktorë dhe nuk e vuan vetëm ky departament, por të gjitha departamentet që ofrojnë programe studimi në mesuesi në universitetet rajonale. Si rrjedhojë prej UK-së, prej Fakultetit të Edukimit, ku bën pjesë ky departament, duhen hartuar politika më të detajuara dhe gjithëpërfshirëse për të rritur numrin e studentëve.

Meqë pas zhvillimit të këtij program studimi, bachelor, studenti i ka të pakta mundësitë e punësimit DGJL si dhe strukturat përkatëse të UK-së duhet të jenë më në kontakt me të diplomuarit (alumni) dhe të krijojnë databazën e alumnit edhe në nivel departamenti.



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) përbëhet nga Prof.As Monika Hasani (Hoshafi), Universiteti Ismail Qemali, Vlorë, dhe Dr. Elida Begaj, QShA, që të dyja eksperte të fushës së gjuhësisë dhe letërsisë. Në punën e tij, GVJ u asistua nga specialistja e ASCAL-it.

Grupi studjoi me shumë kujdes Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të Departamentit të Gjuhë-Letërsisë (tetor 2021) (RVB Gjuhë-Letërsi), për t'u njohur paraprakisht me gjendjen dhe problematikën e programit. Bazuar në këtë informacion u hartua një draft paraprak i raportit të GVJ-së, shoqëruar me një seri pyetjesh që lindën gjatë studimit të tij. Gjatë vizitës dy ditore (08 dhe 09 Nëntor 2021) pranë njësisë, pyetjet në fjalë iu adresuan personave përgjegjës. Përgjigjet e marra u bënë pjesë e dokumentit final të këtij raporti. Gjatë vizitës në IAL, GVJ mori kontakte dhe bisedoi me personat e poshtëshënuar;

- Rektori i Universitetit të Korçës
- Zv/Rektori i Universitetit të Korçës
- Drejtuesen e departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë
- Grupin e vetëvlerësimit të programit
- Stafin akademik të Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë
- Qendrën e Karrierës dhe Alumni
- Përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrën e Mësimit dhe Kurrikulave
- Studentë të programit
- Zyrën e Burimeve Njerëzore
- Zyrën e Studimeve dhe Studentëve, si dhe Sekretarinë mësimore

GVJ vizitoi mjediset e mësimit dhe aktivitetit tjetër studentor në IAL (auditorë, laboratorë, biblioteka).

Ky raport pasqyron përmbledhtazi mendimet tona për programin. Ndonëse, në tërësinë e vet raportit ynë konfirmon gjetjet kryesore të RVB-së, ndan qëndrime të ndryshme prej tij lidhur me aspekte të caktuara të gjendjes dhe shkallës së plotësimit të standardeve të cilësisë së programit.

Në përfundim të këtij procesi, grupi përgatiti dhe dorëzoi draft-raportin tek kordinatori teknik i ASCAL-it, Msc. Arjana Alija.

Universiteti "Fan S. Noli", Korçë është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 01.03.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 4/21 Prot, datë 01.03.2022. Universiteti "Fan S. Noli", përcjell në ASCAL, me anë të shkresës me Nr.386/1 Prot, datë 07.03.2022, "Kthim përgjigje mbi draft raportin e vlerësimit të jashtëm", ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga ekspertët e jashtëm. Në këtë mënyrë Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “ Gjuhë-Letërsi”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit bachelor në “Gjuhë-Letërsi” është në përputhje me qëllimet dhe misionin e Universitetit ‘Fan S. Noli’ të Korçës (<i>Shtojca 1.1 – Statuti i UK.pdf; Shtojca 1.03 – Plani strategjik UNIKO,f. 9-11.pdf</i>). Ky program synon të ruajë dhe të zhvillojë vlerat e kulturës sonë kombëtare dhe është plotësisht në përputhje me interesat tona kombëtare.
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Ekzistenca dhe nevoja e vijimësisë së këtij programi studimi është tërësisht e mbështetur nga Dekani i Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë (<i>Shtojca 1.41-Mendimi i Dekanit.pdf</i>) dhe u konfirmua edhe gjatë takimit të zhvilluar me Zv/Rektoren e universitetit. Programi synon “të ofrojë shërbim arsimorë në nivelin më të lartë në fushën e arsimit, kulturës dhe albanologjisë, duke ruajtur vlerat akademike dhe kulturore kombëtare. (<i>Shtojca 1.40-Strategjia e zhvillimit të departamentit.pdf</i> .)
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Ky program i shërben më së miri interesit kombëtar të formimit të specialistëve të aftë dhe profesionistëve të mirëfilltë, të cilët mund të punojnë në sektorin publik dhe jo publik, por edhe me profesion të lirë në shërbim të ruajtjes e konsolidimit të gjuhës dhe kulturës shqipe, të promovimit të vlerave të kulturës sonë kombëtare si studiues, apo specialistë në sektorë strategjikë të arsimit, kulturës dhe administratës si në nivelin shtetëror, ashtu edhe në nivelin vendor.
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Programi i është nënshtruar vlerësimit periodik të përshtatshmërisë së tij me tendencat e zhvillimit të arsimit dhe kulturës në vend dhe rajon (<i>Shtojca 1.24-Kurrikula e programit, seksioni 3 bazë.pdf; Shtojca 3.7-Raport vjetori i NjSBC.pdf</i>) dhe kërkesave të tregut të punës (<i>Shtojca 3.12-Studim tregu për programin e studimit BSc “Gjuhë-Letërsi”.pdf</i>). Ndryshimet në program dhe procedura e ndjekur janë korrekte dhe të dokumentuara (<i>Shtojca 2.05-Struktura e planit mësimor.pdf</i>).

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Standardi I.2				
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.				
Kriteret	Vlerësimi			
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programi i studimit është plotësisht në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit (<i>Shtojca 1.3 – Plani strategjik, f.19 UNIKO.pdf</i>), statutin e UNIKO (<i>Shtojca 1.01 – Statuti i UK.pdf</i>), si dhe Strategjisë së departamentit (<i>Shtojca 1.39</i>). Statuti i UNIKO-s dhe rregullorja e departamentit (<i>Shtojca 1.03</i>) përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tyre; emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit bachelor në “Gjuhë-Letërsi” është në përputhje me fushat e deklaruara akademike të Universitetit të Korçës dhe Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë dhe të vetë Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë.			
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Programi i studimit hartohet nga Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë dhe miratohet nga Senati Akademik (<i>Shtojca 1.03</i>), (<i>Shtojca 4.13-Fushat e studimit në Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë. pdf</i>). Programet e studimit organizohen në përputhje me Rregulloren që përcakton organizimin e veprimtarisë mësimore dhe shkencore të UNIKO-s, Kreu VI, neni 2 (<i>shtojca1.01</i>).			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Struktura dhe përmbajtja e programit të studimit është hartuar dhe përshtatur plotësisht në përputhje me strategjinë e zhvillimit të UNIKO-s (<i>Shtojca 1.3 – Plani strategjik UNIKO</i>) dhe statutin e UNIKO (<i>Shtojca 1.01 – Statuti i UK.pdf</i>). Statuti i UNIKO), ku përcaktohen qartë drejtimit prioritar akademike të tyre. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit bachelor në “Gjuhë-Letërsi” është në përputhje me fushat e deklaruara akademike të Universitetit të Korçës dhe në mendimin e dekanit Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë (<i>shtojca1.41</i>), si dhe të vetë Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë (<i>Shtojca 1.39-Fushat e studimit në Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë. pdf</i>).			
	Mbështetur në planin strategjik (<i>Shtojca 1.3: Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO 2016 – 2020</i>), në Statutin (<i>Shtojca 1.01: Statuti i Universitetit Fan S. Noli</i>), Miratuar me Urdhërin Nr. 56, datë 08.02.2018, të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë) dhe rregulloren e studimeve universitare të UNIKO (<i>Shtojca 1.02. Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore dhe Kërkimore e UNIKO</i>) janë të përcaktuar qartë të gjitha drejtimit prioritar akademike.			

	Struktura e programeve të studimit, lloji i programit të studimit dhe diploma që lëshohet në mbarimin e tij, emërtimi i programit të studimit, gjuha e studimeve, forma e studimeve, kohëzgjatja e studimeve, aktorët e interesit, kreditet, metodat e vlerësimit, kriteret e pranimit në programet e studimit, rezultatet e të nxënit, komponentët mësimorë të programit të studimit, rregulloret, plani mësimor, diploma dhe suplementi, frekuentimi, etj., janë në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit. Programi është ndërtuar dhe organizuar mbi bazë e Rregullores së organizimit dhe veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore të Unive Universitetit “Fan S. Noli” dhe Statutin e Universitetit. (Shtojcat 1.01 & 1.02)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	Programi i studimit ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në këtë program, përfshirë dije, aftësi dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të (Shtojca 1.24 -Kurrikula e programit të studimit-syllabuset.compressed pdf), si dhe Strategjia e zhvillimit të departamentit (Shtojca 1.40) kanë të përcaktuara qartë kompetencat profesionale që duhet të përfitojnë studentët në përfundim të tij. Struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit (Shtojca 1.24) dhe rezultatet e pritshme të të nxënit (Shtojca 2.8), garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.
Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të	Pavarësisht plotësimit në tërësi të kërkesave të këtij standardi, grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) vëren se; <ul style="list-style-type: none"> - Njësia bazë, përgjegjëse për realizimin e programit ka grumbulluar informacion për punësimin e të diplomuarve në bashkitë e rajonit dhe disa institucione dhe ka kryer një studim të tregut të punës (Shtojca 1.44), ku ka disa të dhëna të studentëve të punedhënësve, por studimi nuk është i organizuar në formën e mirëfilltë të një baze të dhënash. - Për shkak se nuk jepet informacion për kohën e diplomimit dhe të punësimit nuk është e mundur të vlerësohet se sa përqind e të diplomuarve të viteve të fundit (programi në fjalë ka vetëm pak vite që është hapur) janë punësuar dhe

<p>diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p><i>se cilat janë tendencat e punësimit në vende pune që përkohë me kompetencat e përfuara nga programi mësimor.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Njësia bazë ka realizuar një studim të tregut të punës (<i>Shtojca 1.24- Studim tregu pune për programin e studimit BA Gj-L pdf</i>) (konsiderohet periodik, por i mungon data e realizimit dhe periodiciteti) të cilin e merr parasysh në miratimin e kuotave të pranimit. Studimi identifikon institucionet dhe kompanitë e mundshme të punësimit të studentëve që diplomohen, por nuk i kuantifikon nevojat e këtyre institucioneve/kompanive për të diplomuar të rinj në një perspektivë afatshkurtër/afatmesme.</p> <p>Objektivat formuese të programit realizohen plotësisht nëpërmjet planifikimit të grup-lëndëve për përfundimin e kompetencave të fushës, formimit të aftësive dhe njohurive të nevojshme në përgjigje të tregut të punës dhe të punësimit të të rinjve.</p> <p><i>Për rrjedhojë GVJ rekomandon:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <i>Institucioni të përditësojë dhe përmirësojë studimet për tregun e punës të programit të studimit bachelor në “Gjuhë-Letërsi”, duke zgjeruar fushën e studimit të tregut të punës, jo vetëm në fushën e mesuesisë, por edhe në fusha të përafërta.</i> <i>Të krijohet një databazë e llojit alumni edhe në nivel departamenti me qëllim gjurmimin e studentëve ndër vite, punësimin e tyre.</i> 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi I.4</p>	
<p>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Programi i studimit bachelor në “Gjuhë-Letërsi”, është programi bazë në UNIKO, për faktin se mbështet në prioritet kombëtar, të shpallura si të tilla nga Qeveria Shqiptare, siç janë, albanologjia dhe gjuha e kultura shqipe.</p> <p>Emërtimi dhe struktura 3-vjeçare bachelor që ka sot nis me VKM nr.402, dt. 25.05.2005 të MAS-it (<i>Shtojca 1.30- Dokumenti i licensimit të programit të studimit.pdf</i>). Programi ofrohet nga Departamenti i Gjuhë-Letërsisë në Fakultetin e Edukimit dhe</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e</p>	

programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.

Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.

Filologjisë, UNIKO (<https://www.unkorce.edu.al/>) dhe është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë (*Shtojca 1.27*). Personeli akademik i njësisë përgjegjëse për programin e studimit përbëhet nga 11 pedagogë; respektivisht:

Prof.	1
Prof. As.	3
Doktorant	2
Msc	1
Prof. Dr	1

Të gjithë me përvojë pune dhe në përputhje me modulet që mbulojnë në mësimdhënie (*Shtojca 1.33-Jeteshkrimet e stafit të përfshirë në programin e studimit.pdf*).

Profili dhe kualifikimi i stafit është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore-shkencore të programeve që mbulon ky program. Në program ka të angazhuar edhe staf akademik nga njësi të tjera brenda UNIKO-s, të cilët mbulojnë lëndë të profileve karakterizuese apo plotësuese të programit.

Departamenti ka ngritur një strukturë të kordinimit shkencor, (*Shtojca 1.38*), e cila harton planin vjetor të veprimtarive shkencore.

Niveli akademik i personelit mësimdhënës plotëson kërkesat e programit mësimor.

Pavarësisht plotësimit në tërësi të kërkesave të këtij standardi, grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) rekomandon:

- *Përditësimin e listës së publikimeve të stafit akademik në tërësi dhe mbi të gjitha detyrimin e stafit për të realizuar kërkim shkencor dhe për të publikuar në fusha kërkimi që përputhen me natyrën e moduleve mësimore që zhvillojnë.*
- *Plani i veprimtarive shkencore të organizohet me mbledhje dhe vendim departamenti.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi I.5
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi
----------	-----------

<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Realizimi i programit të studimit bachelor në “Gjuhë-Letërsi” zhvillohet nëpërmjet një bashkëpunimi të ngushtë brenda institucionit, ku aktorë të ndryshëm kanë përgjegjësi dhe detyra të mirëpërcaktuara në rregulloret e brendshme të institucionit (<i>Shtojca 1.01-Rregullore e UK.pdf; Shtojca 1.02- Rregullore e njësisë kryesore Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë. pdf; Shtojca 1.27-Rregullore e Departamentit .shtojca 1.39 pdf</i>).</p> <p>Në sa më sipër përcaktohen strukturat përgjegjëse dhe detyrat përkatëse për mbarëvajtjen e programit.</p>			
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Ka marrëveshje bashkëpunimi të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë me institucione publike lokale, aktorë dhe faktorë në zhvillimin e institucionit, me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit. (<i>Shtojca 1.35 Marrëveshjet e UNIKO-s, Shtojca 1.36 Marrëveshjet e FEF</i>).</p>			
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Vetë Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë bën përpjekje për të hartuar raportet e përfitimit nga marrëveshjet me institucione të cilat kanë marrëveshje me Fakultetin, me përfundimet e së cilave marrin vendime të ndryshme në përshtatje me situatat reale konkurruese të tregut, gjithsesi, nuk raportohet që analiza të tilla të jenë kryer për marrëveshjet e nënshkruara me aktorë të tjerë. (<i>Shtojca 1.41</i>)</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p><i>Për momentin, nuk ofrohen trajnime profesionale për studentë e diplomuar, por në raportin e vlerësimit të brendshëm pohohet se po punohet për këtë qëllim.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit bachelor në “Gjuhë-Letërsi” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke i grupuar lëndët/modulet në kategori dhe ngarkesën përkatëse në kredite (<i>Shtojca 1.39-Rregullorja e studimit të programit Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi.pdf</i>). Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) (<i>Shtojca 2.05-Plani mësimor i programit të studimit.pdf</i>).
Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Kurrikula është e orientuar nga kërkesat e tregut të punës dhe është ndërtuar nga një numër i mjaftueshëm disiplinash mësimore të grupuara në module bazë, karakterizuese, integruese, etj. Kurrikula ofron një formim bazë të ekuilibruar duke mundësuar kompetenca të shumëfishta për t’iu përshtatur profileve të mundshme të punës (<i>specialistë të komunikimit, të arsimit, kulturës, medias, redaktori në sektorin publik e privatetj.</i>) (<i>Shtojca 2.05-Plani mësimor i programit të studimit.pdf</i>).
Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Nga shqyrtimi i sillabuseve të moduleve karakterizuese (<i>Shtojca 2.08 – Programet lëndore të programit të studimit_syllabusset.pdf</i>), vihet re trajtimi i tematikave bashkëkohore të lidhura ngushtë me strukturën e zhvillimit tëfushave specifike. Studentët përgatiten të kompetenca teorike dhe praktike thelbësore të fushave të gjuhësisë dhe letërsisë, të kenë mendim kritik dhe aftësi krijuese në zgjidhjen e problemeve të shumëllojshme që shfaqen në terren. Të përfitojnë aftësi komunikuese, prezantuese, redaktoriale.
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Ka informacione të mjaftueshme për të konkluduar që IAL përdor të gjithë elementët e strukturës së programit të studimit (<i>Shtojca 2.5-Rregullorja e studimit të programit bachelor në Gjuhë dhe Letërsi.pdf; Shtojca 2.07-Plani mësimor i programit të studimit.pdf</i>).
	Programet e studimit janë hartuar në përputhje me qëllimin e institucionit, duke synuar përgatitjen e specialistëve të ardhshëm në fushën e gjuhës dhe letërsisë, si dhe për t’iu dhënë mundësi për

<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>studime të mëtejshme në programet e ciklit të dytë “Master profesional” dhe/ose “Master i Shkencave”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se ky program studimi, përsa i përket strukturës dhe elementëve përbërës të tij, është në përputhje të plotë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Gjithashtu, programi është saktësisht i shpërndarë me ngarkesat përkatëse sipas elementëve të zhvillimit të njohurive, leksione, seminare, laboratore etj.</p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit të studimit, mbështetur edhe në VKM 41 (2018), paraqiten grupet e klasifikimit të veprimtarive formuese të pasqyruara në program. Nga shqyrtimi i kurrikulës, syllabuseve etj., rezulton se ky program studimi ka një ndarje të qartë të lëndëve sipas kategorive të përcaktuara, dhe secila prej tyre ka të përcaktuar ngarkesën përkatëse në kredite duke e respektuar sasinë vjetore prej 60 kreditesh. Duke parë rregulloren e programit të studimit theksojme që në planin mësimor janë përcaktuar në mënyrë të detajuar leksionet, seminarët, labororet, ushtrimet (sipas specifikës së çdo lënde), orët e praktikës profesionale, si dhe orët për tezën e diplomës, me ngarkesën javore dhe semestrale (brenda dhe jashtë auditorit), si dhe ECTS për çdo lëndë (<i>Shtojca 2.05</i>).</p> <p>Arrijmë në përfundimin se plani mësimor sipas (<i>Shtojca 2.05</i>) si dhe aktivitetet e tjera formuese, janë në përputhje me informacionin që mund të asimilohet dhe praktikohet nga studentët. Vërehet një ekuilibër ndërmjet orëve teorike dhe praktike dhe është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin. Sipas (<i>Shtojca 2.05</i>) bisedave me stafin e departamenti rezulton që studentët realizojnë ekspedita mësimore profesionale. Kjo e fundit është e përfshirë në planet mësimore dhe strukturën e vitit akademik. Modulet janë të përcaktuara sipas veprimtarisë formuese dhe kjo është e shënuar në syllabusin e modulit. Mbi këtë bazë është bërë edhe përcaktimi i krediteve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë është njësia bazë përgjegjëse për programin bachelor në “Gjuhë-Letërsi”. Departamenti funksionon bazuar në Statutin e Universitetit (<i>Shtojca 1.1-Statuti i UK.pdf</i>), Rregulloren e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë</p>

<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>(Shtojca 2.2- Rregullore e njësisë kryesore Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë.pdf) dhe Rregulloren e departamentit (Shtojca 2.3- Rregullore e njësisë bazë gjuhë- letërsi. pdf). GVJ i gjen statutin dhe rregulloret në përputhje me Ligjin e AL 80/2015 dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij, Neni 106, pika 3dhe 4 (ShtojcaII.08) Organizimi i njësisë kryesore në departamente, stafet akademike përkatëse për secilin departament përmbushin detyrimet ligjore. Programi i studimit është i organizuar dhe funksionon sipas VKM nr.41, pika 2 (Shtojca 2.02). Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, për programin e studimit BA në Gjuhë-Letërsi, ka në strukturën e vet një kordinator, i cili luan një rol të rëndësishëm dhe aktiv për realizimin e programit dhe për ecurinë e tij në mënyrë të detajuar (Shtojca II.09). Detyrat e tij janë të përcaktuara në rregulloren e departamentit Kreu III, neni 14 (Shtojca 2.39). Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë ka staf të kualifikuar sipas kriterëve ligjore në fuqi. Departamenti ka në përbërje një staf prej 11 pedagogësh, rrjedhimisht përmbush kërkesat ligjore sa i takon numrit të personelit akademik dhe kualifikimit të tyre (Shtojca 2.910. Jetëshkrimet e stafit të përfshirë në në programin e studimit.pdf). Kualifikimi i stafit akademik përkon me fushën e studimit dhe modulet që secili pedogog mbulon, prej tyre:</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>(1 Prof.Dr, 3 Prof.Asoc, 3. Dr, 2 Doktorantë, 1 Msc dhe 1 Prof.dr me kontratë).</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Në realizimin e programit kontribuojnë edhe 2 pedagogë me kohë të pjesshme, të kualifikuar dhe në mbështetje të nevojave të departamentit, si dhe staf akademik nga departamentet e tjera të UNIKO të angazhuar në programin e studimit. Në ndihmë të procesit mësimor ka një punonjës ndihmës me eksperiencë pune në këtë departament që mbështet punën për realizimin e detyrave që lidhen me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor (Shtojca 2.10). Fakulteti në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, Kreu III, Neni 23 përbëhet nga 4 departamente dhe ofron programe studimi me kohë të plotë (Shtojca 1.27- Rregullore e FEF), Bachelor, Programe profesionale 2 vjecare, Programe studimi Master profesional dhe Programe Studimi Master shkencor. Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë ofron 4 programe studimi; Gjuhë-Letërsi (BSc), (Program profesional 2 vjeçar), Program studimi Master profesional dhe Program Studimi Master shkencor (Shtojca 4.3- Tabela e programeve të studimit që ofron njësia bazë gjuhë-letërsi. pdf). Përgjegjësi i departamentit është koordinatori i të gjithë programeve; ndërkohë që secili nga programet ka gjithashtu koordinatoren e vet (Shtojca 2.11- Vendim i njësisë bazë</p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Në realizimin e programit kontribuojnë edhe 2 pedagogë me kohë të pjesshme, të kualifikuar dhe në mbështetje të nevojave të departamentit, si dhe staf akademik nga departamentet e tjera të UNIKO të angazhuar në programin e studimit. Në ndihmë të procesit mësimor ka një punonjës ndihmës me eksperiencë pune në këtë departament që mbështet punën për realizimin e detyrave që lidhen me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor (Shtojca 2.10). Fakulteti në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, Kreu III, Neni 23 përbëhet nga 4 departamente dhe ofron programe studimi me kohë të plotë (Shtojca 1.27- Rregullore e FEF), Bachelor, Programe profesionale 2 vjecare, Programe studimi Master profesional dhe Programe Studimi Master shkencor. Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë ofron 4 programe studimi; Gjuhë-Letërsi (BSc), (Program profesional 2 vjeçar), Program studimi Master profesional dhe Program Studimi Master shkencor (Shtojca 4.3- Tabela e programeve të studimit që ofron njësia bazë gjuhë-letërsi. pdf). Përgjegjësi i departamentit është koordinatori i të gjithë programeve; ndërkohë që secili nga programet ka gjithashtu koordinatoren e vet (Shtojca 2.11- Vendim i njësisë bazë</p>

	<p><i>për emërimin e koordinatorëve të programit.pdf</i>). Njësia përgjegjëse ka caktuar një prej anëtarëve të saj në rolin e koordinatorit të programit, i cili ishte i mirëinformuar lidhur me ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale. Sa më sipër ishte në përputhje me objektivat e programit si dhe garantonte qëndrueshmërinë e tij.</p> <p>Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë përmbush detyrimet ligjore përsa i përket strukturës akademike, kualifikimeve të stafit, ngarkesës mësimore në auditor të detyrueshme sipas kategorive përkatëse të personelit akademik.</p> <p>Sipas (<i>Shtojca 2.10</i>) rezulton që kjo njësi përmbush detyrimet që rrjedhin nga aktet ligjore dhe nënligjore duke ushtruar kompetenca të plota mbi mbarëvajtjen e mësimit dhe kërkimit, siç përcaktohet edhe në rregulloren e studimeve të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë dhe të programit Bsc në “Gjuhë-Letërsi”.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë, përgjegjës për programin e studimit të ciklit të parë bachelor në ‘Gjuhë-Letërsi’ disponon informacionin e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit. Programi i studimit bazohet në Rregulloren e studimit të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë (<i>Shtojca 2.02-Rregullore e njësisë bazë gjuhë-letërsi. pdf</i>), Rregulloren e departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë (<i>Shtojca 1.39-Rregullore e njësisë bazë Gjuhë-Letërsi. pdf</i>), Rregulloren e programit të studimit bachelor në ‘Gjuhë-Letërsi’ (<i>Shtojca 1.24</i>) dhe planin mësimor (<i>Shtojca 2.01 Plani mësimor programit të studimit.pdf</i>).
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Programi i studimit është i organizuar në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, gjithsej 44 veprimtari, (<i>Shtojca 2.02-Plani mësimor i programit të studimit.pdf</i>). Programi i studimit është

<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>organizuar në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra. Në planin mësimor përfshihen informacionet të detajuara për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit,specifikime të vitit dhe semestrit kur ofrohet moduli, numri i krediteve, ngarkesa e orëve në auditor dhe jashtëauditorit, ndarja e orëve në leksione seminare, ushtrime, detyra kursi sipas natyrës ë modulit. ndërkohë që syllabuse përshkruhet në mënyrë të detajuar mënyrën e vlerësimit të dijeve. Këto të fundit (syllabuset e detajuara) janë të hartuara për secilën lëndë dhe japin informacion të mjaftueshëm për të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm, ajo rishikohet në mënyrë periodike me qëllim përmirësimin e programit në përputhje me kuadrin ligjor (Shtojca 1.27).</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Programi është riorganizuar deri në masën 20%. (Shtojca 1.39-rregullore e departamenti, kreu II.Neni9/c pdf; Shtojca 2.11-Procedura e ndryshimeve në planin mësimor rishikimi i kurrikulës.pdf). Në fund të të çdo viti akademik në një takim të vecantë argumentohen dhe propozohen ndryshimet në planin mësimor. Në departament arkivohet dosja e plotë e procesit të ndryshimit të programit. Dosja e sillabuseve rishikohet cdo fillim viti akdemik dhe bëhen përmirësimet e mundshme (Shtojca 1.25).</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Rregulloret e lartpërmendura përmbajnë gjithashtu informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Megjithatë, GVJ vëren se;</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>• <i>Rregullorja e programit të studimit në pjesën më të madhe të saj përbëhet nga informacione të përgjithshme. Është i nevojshëm përmirësimi i saj me informacione më të detajuara dhe që lidhen drejtpërdrejt me ecurinë e programit, përmbajtjes së tij dhe përfshirjen në projekte kombëtare deh ndërkombëtare, duhet të përshkruhen detaje rreth organizimit të mësimit, provimeve, riprovimeve, ankesave dhe mënyrës së zgjidhjes së tyre, pranimit dhe transferimit të studentëve, etj.</i></p>
	<p>Shuma e krediteve minimale për të kaluar në vitin pasadhës duhet konsultuar edhe njëherë në departament, për t’ia përcjellë Senatit akademik për vendimmarrje të mëtejshme.</p> <p><i>Për rrjedhojë GVJ rekomandon:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimin e rregullores së programit të studimit.

	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Rishikimin e numrit minimal të krediteve për të kaluar në vitin pasardhës në funksion të rritjes së tyre.</i> 			
Shkalla e përbushjes së standardit	Plot	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
<p>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Programi i studimit plotëson kërkesat e VKM-së 41 dt. 24.1.2018. Ngarkesa realizohet me 180 kredite, me kohëzgjatje normale 3 vjecare, shtrirë në tri semestra. Ngarkesa javore është 20-25 orë dhe cdo semestër ka 15 javë mësimore (<i>Shtojca 1.24</i>) dhe (<i>Shtojca II.02</i>).
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	Nga shqyrtimi i planit mësimor dhe kurrikulës (<i>Shtojca 1.24-Plani mësimor i programit të studimit.pdf</i> ; <i>Shtojca 2.05-Programet lëndore të programit të studimit syllabuset.pdf</i>) vërehet se ka një raport të drejtë ndërmjet moduleve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe plotësuese, në përputhje me kërkesat e VKM 41 dt. 24.1.2018. Po ashtu, vërehet se raporti teori – praktikë në orë dhe kredite duhet të jetë i balancuar më drejt, duke krijuar mundësi për një formim teorik të barazpeshuar si dhe zhvillim të aftësive praktike të mjaftueshëm (<i>Shtojca 1.24-Plani mësimor i programit të studimit.pdf</i>). Në përgjithësi lëndët kanë një shpërndarje logjike në përputhje me kërkesat e VKM-së 41, si dhe me profilin e dhe nevjat e specialitetit.
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.	Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. Përmbajtja e programit të studimit bachelor në ‘Gjuhë-Letërsi’ rezultojnë të integruar mirë me diploma të tjera në ciklin e dytë të studimeve, që ofron njësi bazë përgjegjëse sic është edhe programi i studimit Master Profesional në “Mësuesi për gjuhën shqipe dhe letërsinë”. Po ashtu, ky program ka përputhje shumë të mirë edhe me programin e ciklit të dytë “Master i shkencave në Kulturë, Media dhe Editim”.
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre si dhe detaje të tjera janë përcaktuar në Rregulloren e programit të studimit (<i>Shtojca 2.5</i>), modulet janë të shpërndara në mënyrë të ekuilibruar midis veprimtarive formuese, me një raport që përputhet me atë të Shtojcës 1 të VKM 41 (i ndryshuar) dt. 24.1.2018.
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave	

<p>formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Të gjitha lëndët janë në përputhje me profilin e programit, dhe rrjedhimisht të domosdoshme për formimin e specialistëve në këtë fushë studimi. Lëndët dhe modulet reflektojnë emërtimin e programit dhe nevojat e specialitetit.</p>			
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Nga infrastruktura, bisedat me stafin etj, rezultojnë qartë se raporti teori/praktikë është i përshtatshëm për finalizimin me sukses të programit. Kurikula përafron me programe të ngjashme ndërkombëtare. Një pjesë e mirë e stafit ka kryer kualifikime jashtë vendit dhe sjellin përvojë nga universitete jashtë vendit. [shtojca 1.35, 1.36], kjo lehtëson arritjen e objektivave formuese, mobilitetin dhe lehtëson punësimin në përfundim të studimeve.</p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Përmirësimi i programit të studimit dhe cilësia e mësimdhënies garantohej në mënyrë të vazhdueshme nga përditësimi i literaturës. Përmirësimi i programeve lëndore mundësohet edhe nga përditësimi që pedagogët u bëjnë programeve lëndore. Një pjesë e lëndëve të këtij programi studimi realizohet me tekste universitare, të cilat gjenden edhe në bibliotekën e FEF. (Shtojca 1.37, Lista e librave). Biblioteka digjitale e UNIKO-s mundëson akses për stafin dhe studentët.</p>			
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programet lëndore janë të plota dhe mundësojnë përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave nga studentët të synuara për ciklin e parë të studimeve në Bachelor për Gjuhë-Letërsi.</p>			
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Sistemi i njohurive të marra u ofron studentëve mundësi për ndjekjen e studimeve të thelluara profesionale deh shkencore brenda fushes se studimit. Ky departament ofron për studime të mëtejshme dy programe master, Master Profesional në “ Mësuesi për gjuhën shqipe dhe Letërsinë” dhe Master i Shkencave “ Kulturë, Media dhe Editim”. Nga bisedat me stafin akademik verëjtem se edhe këto programe janë në përmirësim të vazhdueshëm në shërbim të përmirësimit të treguesve të cilësisë.</p> <p>Në përfundim të cdo viti akademik departamenti bën rishikimin e programit të studimit duke diskutuar dhe propozuar ndryshime të mundshme.</p> <p>Lidhjet me bashkëpunëtorët dhe tregun e punës bëhen kryesisht në bashkëpunim me QKA.</p> <p><i>GVJ rekomandon:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Pasurimin e bibliotekës së UK dhe bibliotekës së Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë me tituj librash të rinj dhe zgjerimin e aksesit në burimet online të literaturës gjuhësore dhe filologjike.</i> • <i>Ngritjen e një Bordi konsultimi me partnerë strategjikë të rajonit për tregun e punës në nivel fakulteti.</i> 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit bachelor në ‘Gjuhë-Letërsi’ mbulohe nga pedagogë të Departamentit të Gjuhë-letërsisë dhe pedagogë të departamenteve të tjera të Universitetit të Korçës. Stafi akademik për për 1 cikël të plotë studimi është si mëposhtë: Viti 2019-2020 Numri i pedagogëve të brendshëm të departamentit të përfshirë në program është 10, (2 Prof.Dr. 3 Prof. As, 2 Dr, 1 Doktorant, 2 Msc) Numri i pedagogëve të brendshëm të UNIKO (pra nga dep të tjera) është 4. Numri i pedagogëve të jashtëm është 2.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Viti 2020-2021 Numri i pedagogëve të brendshëm të departamentit të përfshirë në program është 11, (2 Prof.Dr, 3 Prof.As, 3 Dr, 1 Doktorant, 2 Msc) Numri i pedagogëve të brendshëm të UNIKO (pra nga dep të tjera) është 3. Numri i pedagogëve të jashtëm është 5. Viti 2021-2022 Numri i pedagogëve të brendshëm të departamentit të përfshirë në program është 11, (2 Prof.Dr, 3 Prof.As, 3 Dr, 1 Doktorant, 2 Msc) Numri i pedagogëve të brendshëm të UNIKO (pra nga dep të tjera) është 5. Numri i pedagogëve të jashtëm është 3.</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>(Shtojca 1.32. Të dhëna për personelin akademik të Departamentit të Gjuhë-Letërsisë. pdf). 11 persona nga numri total i stafit akademik që mbulon këtë program studimi janë pjesë përbërëse e vetë Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë. 1 Prof. Dr është i angazhuar me kontratë, 2 janë pedagogë me kohë të pjesshme, 2 pjesëtarë të stafit janë pjesë e departamente të tjera të Universitetit të Korçës. Stafi akademik i angazhuar ka shkallë të lartë kualifikimi, ku pjesa më e madhe e tyre zotërojnë tituj dhe grada shkencore (Shtojca 2.10-cv e stafit akademik).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike</p>	<p>Kualifikimi dhe përvoja e stafit është në përputhje me lëndët që zhvillohen në program. Tregohet kujdes që anëtarët më të kualifikuar të mbulojnë lëndët që kanë lidhje sipas specifikave që ka programi. (Shtojca 1.33), Ekperienca të mëparshme në funksione të ndryshme drejtuese, të një pjese të stafit akademik përbëjnë një aset shtesë në funksion të rritjes së cilësisë së programit të studimit. Thënë në tërësi, stafi akademik që mbulon programin e studimit ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, me ndonjë përjashtim të rrallë, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e</p>

sipas natyrës së programit të studimit.	<p>moduleve të tij. Shpërndarja e pedagogëve në modulet që mbulojnë është në përputhje me formimin e tyre të ngushtë profesional. Konstatohen raste të pedagogëve që mbulojnë njëkohësisht dy apo tre module.</p> <p>Parimisht, mbulimi nga një pedagog i vetëm nuk influencon negativisht në mësimdhënie.</p> <p>Formimi profesional i pedagogëve garanton mbarëvajtjen e procesit mësimor në auditor dhe në instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në ekspedita mësimore dhe punimin e diplomës.</p> <p>Angazhimi i tyre në ndjekjen e ekspeditave mësimore dhe profesionale të studentëve, si edhe drejtimi i temave të diplomimit të studentëve është detyrim dhe angazhim konstant i të gjithë stafit akademik.</p> <p>Në departamentin e Gjuhë-letërsisë ka vetëm një të punësuar si personel jo akademik, që kryen njëkohësisht detyra administrative dhe në ndihmë të procesit mësimor. Gjithsesi, në nivel fakulteti ka një numër të mjaftueshëm punonjësish jo akademikë, të aftë profesionalisht për të kontribuar në ndihmë të procesit mësimor.</p> <p>Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera të larta në vend e me gjerë [shtojca 1.36]. UK ka bashkëpunim insstitucional me Bashkinë e Korçës, të Devollit në ndihmë të studentëve, për praktika, punësim dhe lehtësira të tjera institucionale. Gjykojmë se rrjeti i këtyre modeleve të bashkëpunimit duhet shtrirë me gjerë edhe në nivel fakulteti, apo departamenti.</p> <p><i>Nisur nga programet e studimit që mbulon departamenti dhe funksionimin e tyre sugjerojmë të rivlerësohet ngarkesa e stafit nga autoritetet drejtuese të institucionit, në funksion të zvogëlimit të ngarkesës mësimore të stafit, nëpërmjet rekrutimit të stafit të ri akademik, së paku me kohë të pjeshme. Kjo do t'i mundësonte stafit aktual më shumë kohë dhe mundësi për angazhim në aktivitete kërkimore dhe publikime, si dhe do të rriste cilësinë e mësimdhënies.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-4342

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>UK ka hartuar dhe miratuar “Statutin” (<i>Shtojca 1.1-Statuti i UK.pdf</i>) dhe “Rregulloren e studimeve universitare” (<i>Shtojca 1.2-Rregullorja e UK.pdf</i>) të cilat rregullojnë kuadrin e përgjithshëm institucional të mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe në këtë kontekst udhëzojnë zhvillimin dhe shfrytëzimin e metodave innovative në mësimdhënije. Në rregulloret e FEF (<i>Shtojca 1.27-.pdf</i>) dhe Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë (<i>Shtojca 2.05-Rregullore e njësisë bazë gjuhë-letërsi. Pdf</i>) përcaktohen gjithashtu metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>UK ka hartuar specifikisht “Udhëzuesin për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies” (<i>Shtojca 3.24-Manual për mësimin online.pdf</i>). Thënë në tërësi, UK promovon shembuj të praktikave të mira dhe nxit e inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Nga takimet me stafin e departamentit dhe studentët e programit të studimit doli në pah se dy vitet e fundit mësimore metodat e mësimdhënies me anën e programeve të ndryshme kompjuterike ishte mjeti i shfrytëzuar për shkak të kushteve të krijuara nga pandemia (Covid 19).</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Statuti dhe rregulloret parashikojnë monitorimin e aftësive mësimdhënëse të stafit akademik nëpërmjet tërheqjes periodike të opinionëve të studentëve me anë pyetësorëve tip (<i>Shtojca 3.13-Model pyetësori studentor.pdf; Shtojca 3.14-Model pyetësori i stafit akademik.pdf</i>). Anketimet e studentëve realizohen periodikisht në përfundim të cdo semestri akademik dhe nga dokumenti shtesë vënë në dispozicion pas vizitës në institucion (<i>Dokument shtesë 3-Raporti i vlerësimit të pyetësorit studentor BA Gj-L.pdf</i>) rezultoi që vitin e fundit ai të ishte realizuar on line. Rezultatet e tyre pohohet se bëhen publike pas përfundimit të procesit. Pas kërkesës, GVJ u njoh me raportin e vlerësimit studentor të vitit të fundit (<i>Dokument shtesë 3-Raporti i vlerësimit të pyetësorit studentor BA Gj-L.pdf</i>). GVJ vërejtë si e ashtuquajtur “model pyetësori i stafit akademik” (<i>Shtojca 2.14</i>) kishte të bënte sërish me tërheqjen e opinionëve të studentëve lidhur me performancën e stafit akademik. Për këtë arsye, GVJ rekomandon përmirësimin e përmbajtjes së dokumentit në fjalë dhe konstaton plotësimin e këtij rekomandimi (<i>Dokument shtesë 4-Model pyetësori i stafit akademik në përfundim të një moduli (nga stafi për studentët) BA Gj-H.pdf</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Rregullorja e organizimit dhe veprimtarisë mësimore, kërkimore-shkencore të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë (Neni 95) ju njeh studentëve të drejtën e ankimit në rast të shkeljes së procedurave të hyrjes në provim, apo për kundërshtimin e mundshëm të rezultateve të provimit.</p>

	<p>UNIKO, strukturat përgjegjëse për monitorim dhe sigurimin e cilësisë, në nivel institucional (<i>Shtojca 1.05</i>) dhe në nivel njësie kryesore (<i>Shtojca 1.27</i>) bëjnë publike rezultat e vlerësimit për vitin e kaluar. Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë zhvillon analiza të ecurisë së procesit mësimor dhe analizën vjetore të procesit mësimor (<i>Shtojca 3.02</i>). Analizat kanë identifikuar problemet dhe kanëparashikuar masa për përmirësimin e situatës, përfshirë promovimin e praktikave të mira të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit Bachelor në “Gjuhë-Letërsi” janë të shumëllojshme; ligjërata, seminare, ushtrime, laboratorë, detyra dhe projekte kursit, provimi i formimit, punimi i diplomës, ekspedita mësimore etj. Format e lartpërmendura mbeten të hapura për përmirësime dhe pasurohen periodikisht me elementë të rinj.</p> <p>Personeli akademik njeh dhe respekton diversitetin e karaktereve dhe interesave individuale të studentëve dhe përshtat metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies me këto vecori. Raporti midis formave të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies ndryshon në varësi të natyrës së moduleve të programit, duke tentuar që në vitin e dytë dhe të tretë të studimeve të rrisë kontaktin e drejtpërdrejtë të studentëve me lëndët e profilit karakterizues, ku u jepet më shumë rëndësi metodave praktike. Përzgjedhja e metodave të mësimdhënies konsiderohen nga stafi akademik si elemente të rëndësishëm të kompetencave didaktike.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Gjatë vizitës në mjediset e institucionit rezultoi se infrastruktura dhe baza materiale në auditore, në dispozicion të personelit akademik dhe studentëve, lejon dhe mundëson aplikimi efektiv të metodave të shumëllojshme të mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson</p>	<p>Sallat e leksioneve seminareve janë të përshtatshme, të pajisura me video-projektor, tabela për të shkruar, kanë sistem ngrohjeje,</p>

<p>përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>dritë të mjaftueshme, hapësira fizike sipas standardeve shtetërore të ndërtimit për mjediset universitare etj.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie demonstroi shkallë të lartë të kualifikimit akademik; <i>(Shtojca 2.10-Jetëshkrimet e stafit të përfshirë në programin e studimit.pdf)</i>, të cilat janë tregues të një profili profesional të plotë brenda fushës. Një pamje e ngjashme është edhe për modulet që ofrohen nga stafi akademik i departamenteve të tjera të UK. Gjithsesi, UK mbështet në mënyrë të vazhdueshme dhe me forma të shumëllojshme (trajtime, mësim të hapura, promovime të praktikave të mira në mësimdhënie) kualifikimin e mëtijshëm të stafit pedagogjik dhe nxit shfrytëzimin e metodave inovative në përputhje me nevojat specifike të punëdhënësve në sektorin publik e privat. Këtij qëllimi i ka shërbyer edhe pjesëmarrja e gjerë e UK në programet ERASMUS+, në kuadër të të cilit janë realizuar një numër i konsiderueshëm vizitash në universitet homologe edhe të pedagogëve të Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë <i>(Shtojca 4.9-Mobilitete staf studentë.pdf)</i>.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Cilësia e mësimdhënies është objekt i përhershëm i analizave vjetore të mësimdhënies nga stafi akademik <i>(Shtojca 3.8-Analiza vjetore e njësisë bazë.pdf; Shtojca 3.29-Analiza vjetore e UNIKO 2018-2019.pdf)</i>, por edhe i vlerësimit të studentëve nëpërmjet anketimit periodik të tyre <i>(Shtojca 3.01-Model pyetësori për cilësinë e mësimdhënies nga stafi akademik.pdf)</i>.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies është interaktiv dhe stimulon punën e pavarur të studentëve. Këtij qëllimi i shërben në mënyrë të vecantë rritja e peshës së detyrave dhe projekteve të kursit në vitin e dytë dhe të tretë të studimeve. Puna për përgatitjen e detyrave dhe projekteve të kursit shtrihet në kohë për disa javë dhe kërkon angazhimin intensiv të studentëve jashtë orëve të mësimi. Si e tillë ajo inkurajon punën në grup të studentëve paralelisht me kontributet individuale të secilit prej tyre. Ndonëse punë e pavarur e studentëve përgatitja e detyrave dhe projekteve të kursit monitorohet e mbështetet nga personeli akademik gjatë të gjithë kohës së realizimit të tyre.</p>
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Mësimi online i mundësuar nëpërmjet aplikacioneve EduMeet, Google Classroom etj, ka ndihmuar në pasurimin metodik të mësimdhënies. Lidhur me aplikacionet stafi në takimin në ambientet e universitetit u shpreh se ka marrë trajtime të vazhdueshme.</p>
	<p>Disa prej lëndëve duke qenë të përbashkëta dhe janë ofruar për klasa të përziera. Ky faktor ka nxitur shqyrtimin e informacioneve në këndvështrime të ndryshme dhe ka ndihmuar në nxitjen e bashkëpunimit mes studentëve.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë ka në dispozicion hapësira të mjaftueshme për zhvillimin e programit mësimor, që pastrohen e mirëmbahen rregullisht nga personeli i shërbimit. Plotësimi i kërkesave standardeve shtetërore për sipërfaqen në dispozicion të zhvillimit të programit mësimor (m ² /student) është konfirmuar edhe nga auditime të realizuara nga MASR (<i>Shtojca 3.04-Të dhëna për infrastrukturën pdf</i>). Auditorët mësimor janë të pajisura me mjetet e nevojshme për realizimin e procesit mësimor (banka, karrige, pajisje audiovizive, tabela të zeza). Gjatë periudhës së pandemisë, sipas pyetjeve drejtuar stafit akademik dhe ndihmes akademik, në mënyrë periodike është bërë higjenizimi dhe disinfektimi i mjediseve në kuadër të masave anticovid.
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Në dispozicion të pedagogëve dhe studentëve ekziston një infrastrukturë e konsoliduar IT-je, që ofron shërbime të shumta dhe cilësore (korrespondencë elektronike, kërkim dhe shfrytëzim online të materialeve didaktike dhe shkencore, informim on line të rezultateve të vlerësimit gjithëvjetor dhe përfundimtar, komunikim elektronik pedagog-student). Pjesë e rëndësishme e infrastrukturës IT, në shërbim të pedagogëve dhe studentëve është sistemi elektronik i vlerësimit gjithëvjetor dhe përfundimtar të studentëve (https://www.unikorcesse3.u-gov.rash.al). Sistemi mundëson informimin në kohë reale të studentëve lidhur me rezultatet e tyre dhe rrit përgjegjshmërinë e pedagogëve për vlerësimin e studentëve dhe transparencën për të gjithë procesin. Në kushtet konkrete të ndërprerjes disa mujore të mësimin në auditor, realizimi i mësimin online është mundësuar nëpërmjet platformës MOODLE (<i>Shtojca 3.24-Manual për mësimin online.pdf</i>).
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Për të gjithë modulet e programit mësimor ekziston literatura bazë në gjuhën shqipe, përgatitur nga pedagogët përkatës. Cilësia e literaturës bazë dhe përputhshmëria e përmbajtjes së tyre me atë të programit të studimit garantohej nëpërmjet diskutimit dhe miratimit të përmbajtjes së teksteve mësimore në departament. Të
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	

<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>mësuarit prej studentëve të lëndëve të formimit profesional mbështetet nga skripte ose tekste mësimore të stafit akademik të departamentit dhe homologëve të tyre në Universitetin e Tiranës, të gjitha ribotime të 5 viteve të fundit. Këtij qëllimi i ka shërbyer blerja nga Biblioteka e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë e një numri të konsiderueshëm tituj librash universitarë të Universitetit të Tiranës.</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Universiteti i Korçës dispon bibliotekën e vet, e cila veç të tjerave ka një fond librash me karakter arsimor. Nga një total prej 14397 librash, 2652 janë libra që i përkasin literaturës shkencore, 304 fjalorë të tipologjive të ndryshme dhe 5491 libra artistikë në gjuhën shqipe (Shtojca 1.37 të dhënat për bibliotekën). Fondi i librave dominohet nga libri shqip dhe është bazuar thuajse tërësisht në dhurime. Në total raportohet për vetëm 50 libra të blerë. Në bibliotekë hyjnë gjithsej 17 tituj periodikësh, 10 prej tyre në gjuhën shqipe (Shtojca 1.37-Të dhëna fondi i bibliotekës.pdf). Pedagogët dhe studentët për një vit (1 Mars 2018-28 Shkurt 2019) kanë patur mundësi të aksesojnë fondet e ProQuest. Rinovimi i kontratës për vijimin e shfrytëzimit të këtij fondi nuk ka qenë i mundur.</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>GVJ pati mundësinë të vizitonte ambientet ndihmëse të mësimdhënies në Fakultetin të Edukimit dhe Filologjisë dhe konstatoi se ata janë të hapur për realizimin e punimeve të thjeshta shkencore nga ana e studentëve. Studentët orientohen në përzgjedhjen e temave të diplomave dhe mbështeten gjatë procesit të realizimit dhe mbrojtjes së tyre. Pedagogu udhëheqës ndjek procesin e punës me studentin dhe garanton cilësinë e punimit. (Shtojca 1.09-Përfshirja e studentëve në punë shkencore.pdf).</p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Procesi i temave të diplomës është i rregullaur dhe i qartë (Shtojca 2.04 Udhëzuesi i diplomës) dhe (Shtojca 2.14 Lista e temave të diplomës). Gjithsesi, problematikë mbetet fakti që shkalla e shfrytëzimit të laboratorit të fonetikës është e kufizuar shfrytëzimin i të cilit mbetet i pamundur nga pamundësia financiare e plotësimit të nevojave për operimin e përditshëm, gjë që kanë bërë që pajisjet të tilla të kushtueshme të mbeten jofunksionale.</p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Nisur nga sa më sipër GVJ rekomandon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • UNIKO duhet të marrë masat e nevojshme për rritjen e efektivitetit të laboratorëve didaktikë-shkencorë në përgjithësi dhe funksionalizimin e pajisjeve moderne në veçanti. • UNIKO duhet të rrisë mbështetjen financiare për pasurimin e Bibliotekës së UNIKO-s dhe Bibliotekës së Fakultetit të

	Edukimit dhe Filologjisë me literaturë filologjike, sidomos në gjuhë të huaj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Për garantimin e cilësisë së mësimdhënies/mësimnxënies UNIKO ka krijuar struktura të posaçme që monitorojnë procesin mësimor. Struktura përgjegjëse në rang universiteti është Drejtoria e Kurrikulave, Sigurisë së Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor (<i>Shtojca 1.01-Statuti i UK.pdf</i>). Brenda kësaj strukture funksionon Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, pjesë përbërëse e të cilit është “Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë” dhe Alumni që ndjek sigurimin e cilësisë. Aktiviteti i këtyre strukturave rregullohet nga “Manuali i Cilësisë” (<i>Shtojca 1.05-Manuali i cilësisë UK.pdf</i>).
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Struktura e mësipërme bashkëpunon me njësitë bazë dhe ka mbështetjen e dekanit , si dhe drejtuesve të departamenteve për programet e studimit që menaxhohen prej tyre, të përcaktuara në rregulloren e DKVI, kreu III, neni 6, (<i>Shtojca 1.01</i>)
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	FEF dhe departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë janë përgjegjësit kryesorë për cilësinë e mësimdhënies në programin e studimit bachelor në “ Gjuhë-Letërsi” (<i>Shtojca 1.27 Rregullore e FEF</i>). Departamenti monitoron rregullisht procesin e mësimdhënies/mësimnxënies dhe atë të vlerësimit të studentëve dhe analizon situatën periodikisht (<i>Shtojca 3-02 Raportet vjetore te departamentit pdf</i>).
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Departamenti i kushton rëndësi përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies/mësimnxënies edhe nëpërmjet nëpërmjet inkurajimit të aktivitetit shkencor të stafit të vet akademik dhe përfshirjes së studentëve në aktivitete shkencore e artistike në fushën e filologjisë (<i>Shtojca 3.28-Përfshirja e studentëve në punë shkencore.pdf</i>). SPK në bashkëpunim me FEF kanë mundur shërbimet e mësimdhënies online dhe kanë organizuar trajnime të personelit akademik me metoda të tilla si, {Edumeet, Google Meet, ESSE3
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	

<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>etj], të cilat kanë ndihmuar në rritjen e cilësisë së mësimdhënies , komunikimit ndërveprues mes pedagogëve dhe studentëve.</p>			
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Kërkimi shkencor dhe aktiviteti botues i stafit akademik analizohen periodikisht në analizat vjetore të departamentit (<i>Shtojca 3.02-Analiza vjetore e njësisë bazë.pdf</i>). Performanca individuale vjetore e stafit akademik monitorohet e vlerësohet rregullisht nëpërmjet plotësimit të formularëve të hartuar për këtë qëllim (<i>Shtojca 2.10-Veprimtaria shkencore e stafit akademik.pdf</i>) [<i>Shtojca III.02-Raportet vjetore të departamentit</i>]. Si stafi akademik, ashtu edhe ai mbështetës, i janë nënshtruar formave të shumëllojshme të trajnimit të tyre personal, kryesisht me fokus në mësimdhënie.</p> <p>Nga vizita në nivel institucional, rezulton se cilësia e mësimdhënies promovohet dhe monitorohet nga Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, e cila është përgjegjëse për koordinimin e procedurave të vlerësimit të njësive akademike të brendshme dhe të jashtme. Kjo strukturë mbështet eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies dhe shërben si burim për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. (<i>Shtojca 1.05</i>)</p> <p>Personeli akademik dhe ndihmës akademik janë tërësisht përgjegjës dhe të angazhuar në programin e studimit. Vihet re një tendencë pozitive në lidhje me përmirësimin e mësimdhënies si dhe implementimin e metodave të reja. Personeli ndihmës akademik ka përvojë të gjatë pune (<i>shtojca II.15 -CV e stafit ndihmës akademik</i>). Rregullorja e FEF ka specifikuar detyrat e personelit ndihmës akademik dhe administrativ (<i>shtojca 1.27</i>).</p> <p>Stafi akademik është autor i një sërë artikujsh në periodikë lokalë/vendas ose të botuar jashtë vendit (<i>Shtojca 2.02-Veprimtaria shkencore e stafit akademik.pdf; Dokument shtesë 1-Lista e botimeve të stafit për 3 vite BA Gj-L.pdf</i>). Stafi akademik është njëkohësisht pjesëmarrës në një numër të madh aktivitetesh shkencore (simpoziume/konferenca) lokale dhe rajonale.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre

Kriteret

Vlerësimi

<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Kriteret dhe mënyra e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve janë pasqyruar në mënyrë të detajuar në Rregulloren e organizimit dhe vprimtarisë mësimore dhe kërkimore të UK (<i>Shtojca 1.2</i>), Rregulloren e organizimit dhe vprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore të Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë (<i>Shtojca 1.27</i>) dhe Rregulloren e brendshme të Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë (<i>shtojca 1.24</i>). Rregulloret përcaktojnë sistemin e vlerësimit, format e vlerësimit dhe të kontrollit të dijeve, kushtet që duhet të plotësojnë studentët për të hyrë në provim, mënyrën e organizimit të provimeve, shpalljen e rezultateve dhe procedurën e ankimimit të studentëve në rast të pakënaqësive për rezultatet e provimit.</p>			
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Bazuar në intervistat në terren me studentë dhe pedagogë rezultoi se studentët informohen në detaje për të gjitha çështjet e mësipërme dhe sidomos për mënyrën e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive në fillim të çdo moduli mësimor. Ato prej pedagogëve, njihen qysh në fillim të sezonit mësimor me përmbajtjen e silabusit, mënyrën e vlerësimit dhe detyrimet e tyre në përmbushje të arritjeve akademike.</p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve ndahet në vlerësimin vazhduar (deri në 30%) të totalit të pikëve dhe atë përfundimtar dhe realizohet në forma të shumëllojshme përfshirë organizimin e seminareve, detyrave të ndërmjetme, ushtrimeve, mbrojtjen e detyrave dhe projekteve të kursit, etj. Provimi përfundimtar zë deri në 70% të totalit të pikëve dhe realizohet me shkrim, me gojë, ose i kombinuar me shkrim dhe gojë, për tu dhënë mundësi studentëve të mbrojnë kompetencat e përftuara gjatë procesit mësimor.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.6</p>	
<p>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Vlerësimi i studentit ndahet në dy pjesë: vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e modulit (30%), si dhe vlerësimi përfundimtar (70%). Mënyra e vlerësimit parashikohet në silabus dhe studenti njoftohet që në fillim të ciklit të leksioneve për përmbajtjen e tij, mënyrën e testimit dhe detyrimet e studentit. (<i>Shtojca 1.25- Kurrikual e programit bachelor ne Gjuhë –Letërs</i>). Testimi realizohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë zhvillimit të lëndës duke kombinuar teste të ndërmjetme me goje e me shkrim, detyra kursi, projektet, prezantime tetj.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	

<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Përcaktimi i raporteve mes vlerësimit të vazhduar gjatë vitit dhe vlerësimit përfundimtar bëhet nga pedagogu/pedagogët në programin e modulit dhe ju bëhet e ditur studentëve me fillimin e modulit mësimor. Pikët e vlerësimit gjatë vitit hidhen në sistemin ESSE3 (<i>Shtojca 1.25-Rregullore ESSE3.pdf</i>) dhe ruhen nga sistemi Marrja e studentëve në provim bëhet nga komisioni i provimit që përcaktohet nga Përgjegjësi i Departamentit. Nga inervista rezultori se ka transparencë të plotë nga ana e pedagogëve për vlerësimin e testeve dhe në raste paqartësie nga ana e studentit, problematikat janë ndjekur dhe sqaruar deri ne formë përfundimtare.</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Çdo student ka llogarinë e tij elektronike, ku njihet me rezultatet e provimeve. Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuar të studentit me tezën e zgjidhur. Mbas këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit. Ne cdo provim ka një komision të përbërë nga dy anëtar. Ne provimet e diplomimit komisionet mund te jene nga tre-pesë anëtarë. Platforma ESSE 3 shërben si një skedar elektronik mjaft efektiv dhe i sigurtë për vlerësimet e studentëve ndër vite.</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Pedagogët orientojnë studentët lidhur me përgatitjet për testimin përfundimtar dhe me informacione të tjera të nevojshme.Kjo konfirmohet edhe nga intervistat e studenteve ne terren.</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Cdo formë e mundshme e kopjimit, ose mashtrimit nga ana e studentit gjatë provimit ndëshkohet me përjashtimin e tij nga provimi dhe shpalljen ngelës për sezonin në fjalë (<i>Shtojca 1.27-Rregullore e njësisë kryesore FEF.pdf, Neni 66, pika f</i>).</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Studentët pohojnë se gjatë vlerësimit të vazhduar (30%), por dhe gjatë vlerësimit përfundimtar (me shkrim dhe me gojë) personeli akademik në mënyrë të vazhdueshme bën sqarime të qarta në mënyrë që edhe vetë studenti të ndërgjegjësohet mbi arritjet momentale dhe të mund të përmirësohet në të ardhmen.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Rezultatet e provimit hidhen në sistem nga komisioni i provimit brenda afateve të përcaktuara. Pas shpalljes së rezultateve, studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij, ose të kundërshtojë rezultatin e marrë brenda dy ditëve (48 orë).</p>
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuar të studentit me tezën e zgjidhur. Mbas këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit (<i>Shtojca 1.6-Rregullore ESSE3.pdf</i>).</p> <p>Në rregullore të FEF është e përcaktuar dhe në cdo syllabus të përgatitur nga pedagogët është e përcaktuar që nuk tolerohet plagjatura, kopjimi në provime dhe detyra.</p>

	<p>Rezultatet e kontrollit të dijeve në rastet e provimeve me shkrim/gojë jepej brenda afatit të përcaktuar në rregullore dhe bazohen në sitemin e meritës. Në <i>shtojcën 1.25</i> paraqitet një model procesverbali i gjeneruar nga sistemi për vlerësimin e lëndës/modulit.</p> <p>Vlerësimet janë të aksesueshme edhe online nga pedagogë e studentë duke përdorur kredencialet e tyre për të aksesuar në sitemin digjital. Studentë kanë të drejtë ta rishikojnë tezën dhe në rrsat ankimi ngrihet nje komisojn nga shefja e departamentit dhe raportohet tek Dekania.</p> <p>Studenti ka të drejtë të ankimohet në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat proceduriale gjatë zhvillimit të provimit ose nuk është dakord me vlerësimin e bërë. Ankesa bëhet me shkrim brenda 48 orëve dhe i drejtohet komisionit të ngritur nga drejtuesi i departamentit.</p> <p>Dekani të fakultetit, i cili përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë, apo jo dhe merr vendimin përkatës.</p> <p>Kur ankesa është e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin student i është ankuar dhe vendos në bashkëpunim me përgjegjësin e Departamentit, që student i të rijapë provimin, me një komision me anëtarë të tjerë.</p> <p>Ankesa, procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë regjistrohen në regjistrin e ankesave të studentëve në dekanat (<i>Shtojca 1.27-Rregullore e njësisë kryesore FEF.pdf</i>).</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët,duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit Bachelor në “Gjuhë-Letërsi” ju ofron studentëve njohuri të qëndrueshme në shkencat e gjuhësisë, letërsisë, albanologjisë dhe filologjisë. (<i>Shtojca 1.25-Planet mësimore të programit mësimor bachelor në Gjuhë-Letërsi. pdf; Shtojca 1.24-Programet lëndore të programit të studimit syllabset_compressed. pdf</i>). Gjatë tri viteve të studimit programi garanton pajisjen e studentëve me njohuri nga fusha e gjuhësisë dhe letërsisë në funksion të zhvillimit dhe rritjes së tyre
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit	

dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	profesionale duke zhvilluar tek ta aftësi të vecanta në formimin e tyre si specialistë të arsimit, komunikimit dhe mësimdhënies.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Formimit të përgjithshëm gjuhësor dhe letrar i paraprihet me zhvillimin moduleve (në vitin e parë dhe të dytë të studimeve) që kanë për mision të rrisin kapacitet e studentëve në fushën e gjuhësisë, albanologjisë letërsisë dhe komunikimit (përfshirë module të mësimin të gjuhës së huaj), si dhe të zhvillojnë aftësitë e veçanta të studentëve në teknologjitë e informacionit, të cilat ju kërkohet ti demonstrojnë më pas në përgatitjen dhe prezantimin e detyrave/projekteve të kursit që duhet të mbrojnë në kuadër të zhvillimit të moduleve me karakter të mirëfillta profesional në vitin e dytë dhe të tretë të studimeve. Në funksion të inkurajimit të diskutimit të ndërsjellë midis studentëve dhe aftësimit për të punuar në grup, një pjesë e mirë e detyrave/projekteve të kursit që duhet të mbrojnë përgatiten dhe prezantohen në grupe të vogla studentësh.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Kompetencat që zhvillohen dhe përvetësohen analizohen në fund të çdo moduli si rezultante e kobinimit të dhe vlerësimit të vzhduar gjatë vitit për elementet e përcaktuar në programin e lëndës [shtojca 1.25], me vlerësimin në provim. Elemente të vlerësimit të vazhduar janë testimet e ndërmjetme me shkrim e me gojë, detyra dhe projekte kursi.
Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Në përfundim të çdo moduli pedagogu orienton studentët lidhur me përgatitjet për provimin përfundimtar, mënyrën e organizimit dhe informacione të tjera të nevojshme për studentin edhe me kërkesa të tij. Sipas rastit pedagogu zhvillon seanca konsultimi përpara zhvillimit të provimit.
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Në përpjekje për të rritur interesin e studentëve për gjuhën dhe letërsinë personeli akademik i kushton vëmendje përfshirjes në leksione zhvillimit të aftësive komunikuese dhe ndërvepruese të studentëve me medota dh e qasje të shumëllojshme pedagogjike, të nxisin imagjinatën dhe inkurajojnë zhvillimin e aftësive krijuese të studentëve. Nga intervista me pedagogoë e studentë rezultojnë që përfshirja e studenteve dhe pedagogoëve në programet ERASMUS ka qenë e nivelitë ulët. Rezulton që FEF ka qenë pjesë e disa projekteve që kanë mundësuar shkëmbime eksperiencash dhe perftim modaliteti të studentëve, por kemi përfshirje shumë të ulët studentëve të departamentit të Gjuhë-Letërsisë.
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Mësimdhënia realizohet mbi bazë kopetencash dhe u jep studentëve mundësi të mira për të zhvilluar njohuri të plota në praktikat profesionale të karakterit mësimor dhe shkencor.
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese	

<p>për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Nga intervistat me studentët ata dëshmojnë se personeli akademik ndihmon dhe mbështet punën në grup, duke nxitur jo vetëm debatin, por dhe diskutimin e gjerë për dijet e marra.</p> <p>Studentëve u kërkohet që njohuritë e përfuara në leksione t'i konkretizojnë nëpërmjet punëve të thjeshta si detyra kursi apo punime diplome.</p> <p>Personeli akademik e zhvillon veprimtarinë e tij në mbështetje të zhvillimit të ideve bashkëkohore dhe me prirje për studime të thelluara shkencore sipas objektivave të programve përkatëse si komunikimi gjuhësor letrar. Departamenti nxit dhe mbështet përfshirjen e studentëve në idetë inovative. Studentët kanë marrë pjesë në konferenca, por ka nga takimet studentët konfirmojnë se personeli akademik mbështet çdo ide personale apo në grup mbi realizimin e një detyrë kursi, praktike profesionale apo teme diplome të sugjeruar nga vetë studentët.</p> <p>Praktika të ndryshme profesionale të karakterit shkencor, artistik dhe letrar për promovimin e studentëve dhe punëve të tyre krijuese realizohen vazhdimisht realizohet në institucione dhe subjekte të ndryshme me të cilat FEF ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi (<i>Shtojca 2.01-Planet mësimore.pdf</i>).</p> <p>Renditen 13 insitucione qendrore dhe lokale, organizata të ndryshme me të cilat realizohen aktivitet të ndryshme në fushën e arsimitë lartë, në funksion të studenteve të departamentit të Gjuhë-Letërsisë. Për të rritur mundësinë e mobilitetit të studentëve si dhe për të siguruar një tranzicion mësimnxënës nga një institucion në tjetrin FEF kryen shkëmbime përvojash në mësimdhënie me institucionet me të cilat ka marrëveshje.</p> <p><i>Nisur nga sa më sipër GVJ rekomandon:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • UNIKO dhe strukturat përgjegjese të përfshijnë më tepër staf dhe studentë të departamentit në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.
--	--

<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht X</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
--	-----------------------	------------------------------	--	------------------------------

<p>Standardi III.8 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>

<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Diplomimi i studentëve të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë-Letërsi” realizohet nëpërmjet mbrojtjes së provimit të formimit, ose nëpërmjet mbrojtjes së një teme diplome. (Shtojca 1.27 Rregullore e FEF), (Shtojca 2.04, Udhëzuesi i diplomës, hartuar nga departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë.) “Udhëzuesi i diplomës [shtojca II,04]. Ky informacion u vihet në dispozicion studentëve përpara fillimit të procedurës së diplomimit.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Tezat e provimit janë të mbështetura në programet orientuese, literatura dhe fondi i pyetjeve i depozituar në departament (Shtojca 2.04 Udhëzuesi i diplomës).</p> <p>Gjatë përgatitjes së punimit të diplomës provimit të formimit studenti mund të shfrytëzojë bibliotekën e FEF, Bibliotekën shkencore të UNIKO-s, si dhe ambiente të institucioneve lokale me të cilat univeërsiteti ka marrëveshje. Në dispozicion të tij janë programet orientuese , literatura dhe fondi i pyetjeve [shtojca II.04]</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Provimi i formimit mbrohet përpara një komisioni të përbërë nga së paku 3 antarë, ku njëri është oponent. Vlerësimi bëhet me notë, e cila është mesatarja e vlerësimit që ka dhënë çdo anëtar i komisionit, menjëherë pas përfundimit të provimit. Në përfundim të procesit të provimit komisioni shpall rezultatet, të cilat hidhen në sistem dhe njëkohësiht procesverbali firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit të diplomimit.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final, sipas detyrimeve të përcaktuara në rregulloren e FEF dhe rregulloren e Departamentit. [shtojca 1.27], [Shtojca II. 24]- Udhëzuesi i diplomës.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Studentëve u ofrohet asistencë për sqarimin dhe saktësimin e detajeve të programit, apo u ofrohen konsultime dhe ju vihen në dispozicion materiale shtesë në funksion të përgatitjes së tyre për provimin e formimit. Në mbështetje të punimit të diplomës udhëheqëit e punimit bashkëpunojnë edhe Zyrtarë Arsimore për të ndihmuar studente në përgatitjet e materialeve, duke u bazuar në marrëveshjet institucionale.</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Në mbështetje të studentëve procesi monitorohet nga drejtuesi i departamentit, zyra e informimit dhe orientimit të studentëve, sekretaria mësimore.</p> <p>Në rastet kur aplikohet përfundimi i studimeve me mbrojtjen e temës së diplomës, udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit. Vlerësimi i njohurive zhvillohet në mënyrë anonime dhe me sekretim .</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Vlerësimi i studentit bëhet me pikë sipas elementeve të vlerësimit që konvertohen me nota, sipas sistemit shqiptar të vlerësimit me dhjete nota. . Pasi studenti njihet me rezultatin e provimit ai ka të drejtë ta nakimojë atë (Shtojca 2.04, shtojca A,B).</p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e</p>	

diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Pasi studenti ka përmbyllur të gjitha detyrimet akademike studentit pajiset me diplomë Bachelor në “Gjuhë-Letërsi”			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Diploma shoqërohet me suplementin sipas modelit të miratuar nga Ministria e Arsimit (<i>Shtojca 2.07</i>). Në përfundim të programit të studimit, studentit pajiset me diplomën përkatëse (<i>Shtojca 2.6-Modeli i diplomës së programit të studimit.pdf</i>).			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Përpara lëshimit diploma regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave. UK dokumenton tërheqjen e diplomës dhe suplementit të diplomës prej secilit student që ka përfunduar me sukses detyrimet akademike dhe ato të tjera institucionale. Regjistri i lëshimit të diplomave depozitohet në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njëzuar me origjinalin ruhet për një kohë të pacaktuar. Paralelisht me diplomën dhe aneksin e saj, studentëve ju vihet në dispozicion një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë-Letërsi”, sipas përcaktimeve të Regullores së UNIKO-s, Kreu VII, Neni 100, shtojca 1.02.			
	Nisur nga sa më sipër GVJ rekomandon:			
	<ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimin dhe përditësimin e infomacionit për studentët lidhur me kërkesat dhe procedurat e provimit përfundimtar 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna	UK ka përparësi të mbledh, ruaj dhe përditësojë çdo vit akademik, të dhënat e personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme jo akademik të angazhuar në programin e studimit (<i>Shtojca 1.4-Rregullore e drejtorisë së burimeve njerëzore.pdf</i>).

<p>përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Gjatë vizitës në IAL-ë, GVJ ka realizuar një takim me pjestarët e zyrës e burimeve njerëzore në të cilën u njoh me dosjet e stafit akademik dhe me kontratat e punësimit të tyre (Shtojcat Model kontrate. shtojca IV. 04, Takim me zyrën e burimeve njerëzore)</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Institucioni ruan dosjet e personelit akademik me kohë të plotë dhe me kontratë në përputhje me legjislacionin (Shtojcat; 1.14; 2.10; Takim, me ZBNJ)</p> <p>Rekrutimin i personelit akademik, realizohet nëpërmjet procedurave specifike, në përputhje me bazën ligjore në fuqi, statutin dhe rregulloren e universitetit.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Referuar takimit me përfaqësues të zyrës së burimeve njerëzore, GVJ konstaton se institucioni bën publike kërkesën për vendin e punës, në përputhje me propozimet e ardhura nga Departamenti, Dekanati dhe miratuar nga titullari IAL. I gjithë procesi i vlerësimit të kandidatëve dhe rekrutimit të personelit akademik administrohet nga Drejtoria e burimeve njerëzore, komunikimit dhe promovimit (Shtojca 1.4-Rregullore e drejtorisë së burimeve njerëzore.pdf Shtojca IV. 0 2).</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Vlerësimi dhe rekrutimit i kandidatëve bazohet në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura në faqen zyrtare e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit (Shtojca IV.02- 1.13-Udhëzimi për rekrutimin e stafit akademik.pdf).</p> <p>Procedura e rekrutimit realizohet nga ZBNJ dhe bëhet publike në Buletin e Njoftimeve Publike dhe në web. Kriteret për stafin që do të rektutohet janë specifike për vendin vakant, dhe theksi kryesor është tek kualifikimi me tituj/grada të kandidatit. Procedura është e qartë dhe transparente.</p> <p>Gjithsesi, GVJ konstatoi nevojën e rekrutimit të stafit të ri akademik në Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë duke pasur parasysh ngarkesën me kreditë të disa moduleve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi IV.2

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-4342

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efëcente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi				
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	UK ofron hapësira të mjaftueshme dhe kushte të mira mësimdhënije për stafin akademik (<i>Shtojca 3.04-Tabela e të dhënave infrastrukturore në funksion të programit të studimit.pdf</i>), Gjatë vizitës GVJ u njoh me mjediset e punës, laboratorët, bibliotekën, sallat e leksioneve, seminareve dhe konstatoi se Universiteti "Fan Noli" e ka prioritet krijimin e mjedisve dhe mundësive të përshtatshme për kryerjen e detyrave të personelit.				
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Infrastruktura dhe mbështetja financiare për angazhimin e stafit në kërkim shkencor është e pamjaftueshme. Për rrjedhojë, aktiviteti shkencor i stafit akademik është modest dhe i pamjaftueshëm. Publikimet shkencore të tij dominohen nga tituj revistash me kredite të ulta. Nga dokumentacioni i ngarkuar (<i>Shtojca IV.07-Veprimtaria shkencore e stafit akademik.pdf</i>). Dokument shtesë 1-Lista e botimeve të stafit për 3 vite BA IAG.pdf), vërehet që publikimet e stafit akademik në 5 vitet e fundit janë të pamjaftueshme dhe thuajse të gjitha publikimet janë në revista me kredite të ulta. Pothuajse mungojnë krejtësisht referencat në Scopus. Në raportet e analizave vjetore të departamentit (<i>Shtojca 3.02, -Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë.pdf</i>) flitet për vetëm 1 artikull të publikuar në revista të listuara në Scopus.				
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Stafi akademik ka shfrytëzuar maksimalisht mundësitë për kualifikime, por ajo që bie në sy është se këto dominohen nga mobilitete ERASMUS, kryesisht në vendet e rajonit, dhe për një kohëzgjatje vetëm disa ditore (<i>Shtojca 4.9-Mobilitete staf studente.pdf</i>).				
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Ngarkesa e normës vjetore për stafin akademik të departamentit (të brendshëm) për vitin 2018-2019 ishte 1120 orë, kurse mbingarkesa 1936 orë; Për të njëjtën normë (1120 orë) në vitin akademik 2019-2020 ky staf ka realizuar faktikisht, orë më shumë se norma (<i>Shtojca 4.09-Tabela e ngarkesës së stafit akademik të angazhuar në programin e studimit.pdf</i>). Mbingarkesa në orë mësimi është për secilin nga antarët e stafit është 1.5 – 2 herë më e lartë se norma vjetore e ngarkesës mësimore. Ngarkesa e madhe në orë mësimi mund të ndikojë negativisht në performancën në mësimdhënije, apo angazhimin në kërkim shkencor. <i>Nisur nga sa më sipër GVJ rekomandon:</i> <ul style="list-style-type: none"> • UK duhet të vlerësojë mundësinë e rekrutimit të stafit të ri akademik për të ulur ngarkesën në mësim të stafit egzistues • UK duhet të marrë masa për mbështetjen e aktivitetit shkencor të stafit akademik të Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë dhe promovimin e publikimit të rezultateve të këtij kërkimi në revista me impakt të lartë në komunitetin shkencor 				
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>UK u siguron studentëve dhe stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. Fakti konfirmohet nga raporti i ekspertëve të MASR për infrastrukturën (<i>Shtojca 1.15-Raport i kontrollit të kapaciteteve të MASR. pdf</i>).</p> <p>GVJ vizitoi ambientet dhe konstatoi se mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>GVJ vizitoi ambientet dhe konstatoi se mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive të mësimdhënies-mësimnxënies.</p> <p>Në dispozicion të zhvillimit të praktikave profesionale të studentëve është zyra arsimore rajonale ose qendra kulturore e qytetit.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit me Zyrën Arsimore vendore, Korçë mundësohet zgjerimi i mundësive të studentëve për kryerjen e praktikave profesionale.</p> <p>Departamenti të programit është një laborator i gjuhëve të huaja me kapacitetet 20 vende, një laborator digjital i pajisur me projektor, një Qendër e Formimit të Vazhduar, një mediatekë të pajisur me projektorë dhe një bibliotekën “Kongresi i Manastirit” e cila ka 6000 mijë tituj shqip dhe në gjuhë të huaj në fondin e saj. Ajo shërben njëkohësisht edhe si sallë studimi. Në infrastrukturë përfshihet edhe një laborator për trajnimin e mësuesit i cili ka 23 PC, fotokopje, smartborder etj. (<i>Shtojcë, 3.04; Të dhëna për infrastrukturën</i>)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Nga informacionet që morëm nga stafi u informuam që laboratori nuk ishte funksional. Do të ishte në të mirë të punës vënia në funksion.</p>

Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Qendra e Zhvillimit dhe Këshillimi të Karrierës përpqet të orienton studentet në zhvillimin e praktikave në institucionet e duhura për zhvillimin e praktikës profesionale por do të ishte me inetrës bashkepunimi me insitucionet e tjera, duke patur parasysh edhe vazhdimësinë në programin e ciklit të dytë dhe do ti ndihmonte për të identifikuar programin e duhur e duhur per zhvillimin institucional .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Universiteti i Korcës ka një bibliotekë qendrore që është në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve të të gjithë programeve të tij të studimit. Ambientet e bibliotekës qendrore janë të bollshme, të mirë ndricuara dhe mirëpajisura. Një pjesë e mirë e informacionit të fondit të tij është e dixhitalizuar dhe lehtësisht e aksesueshme. Nga ana e tij, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë ka krijuar bibliotekën e vet, në dobi të studentëve të programeve të tij të studimit.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Të drejtën për të qenë anëtar i bibliotekës e kanë studentët, personeli akademik, ndihmës akademik, administrativ si dhe komuniteti, të cilët janë të paisur me kartela personale. Biblioteka gjatë ditëve të javës është e hapur dhe në dispozicion të lexuesve në orarin 8:00-16:00. Biblioteka shfrytëzohet në mënyrë të barabartë nga të gjithë studentët e programeve të studimit të ofruara nga UNIKO. Vitet e fundit janë bërë përpjekje për të pasuruar fondin e bibliotekës së Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë me literaturë shqip, kryesisht botime të Universitetit Bujqësor, Tiranë. Tekstet në fjalë janë në dispozicion të studentëve të programit të studimit “Gjuhë-Letërsi”, pa pagesë.
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Gjithsesi, GVJ vërejti se si në bibliotekën qendrore dhe atë të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë fondi i librit është i kufizuar. Në mënyrë të vecantë. Fondi i filologjisë, Albanologjisë dhe

<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Letërsisë bashkëkohore, i periodikëve shkencorë në gjuhë të huaj është i pamjaftueshëm.</p> <p>Vetë stafi akademik i Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë artikuloi problemin e shpërndarjes së pabarabartë të fondeve për librin e ri midis fakulteteve të ndryshme të UK.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p><i>Në këto rrethana GVJ i sugjeron Universitetit të Korçës rritjen e buxhetit në funksion të pasurimit të fondit të librit dhe periodikëve shkencor, botimeve të Albanologjisë, filologjisë dhe letërsisë të bibliotekës së tij qendrore dhe asaj të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, si edhe riaktivizimin e marrëveshjeve të mëparshme me ProQuest, apo platforma të tjera të ngjashme dixhitale që ofrojnë informacion bashkëkohor teknik dhe shkencor për filologjinë.</i></p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi IV.5 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>UK përdor sistemin ESSE3 për administrimin e informacionit që lidhet me studentët. Sistemi ka rritur ndjeshëm cilësinë e shërbimit ndaj studentëve në çdo aspekt të procesit, nga regjistrimi, transferimi, transkriptet e notave, etj, deri në diplomim. Në sistem janë të integruara pagesat e tarifave të shkollimit dhe i shërbimeve të tjera. Shfrytëzimi ESSE3 bazohet në një rregullore të vecantë (<i>Shtojca 1.6-Rregullore e ESSE3.pdf</i>). Marrëveshja përkatëse me rrjetin akademik shqiptar (RASH) mundëson funksionalitetin dhe mirëmbajtjen e plotë të sistemit (<i>Shtojca 1.6.1-Marrëveshja RASH për ESSE3.pdf</i>). Studentët dhe pedagogët kanë akses të personalizuar në ESSE3. Siguria e të dhënave, garantohet nga respektimi i dispozitave të ligjit 9887 për mbrojtjen e të dhënave personale (<i>Shtojca 1.9-Rregullore e ruajtjes së të dhënave.pdf</i>).</p> <p>Informacioni në UK mbahet në regjistra të shkruar me dorë dhe në format elektronikë (<i>Shtojca 1.10-Rregullore e sekretarisë</i>)</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit</p>	

administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	<i>mësimore.pdf, Neni 13</i>). Regjistrat e shkruar me dorë kanë përparësi por për korrigjimet e mundshme në ata ka një rregullore të vecantë (<i>Shtojca 1.10-Rregullore e sekretarisë mësimore.pdf, Neni 10</i>).			
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Elementë të tjerë të rëndësishëm të dokumentimit të aktivitetit të studentëve dhe pedagogëve janë regjistrat e pedagogëve dhe formularët e ngarkesës mësimore (<i>Shtojca 4.2-Tabela e ngarkesës së stafit akademik të angazhuar në programin e studimit.pdf; Aneksi 4.14-Ngarkesa e plotë mësimore e stafit të gjuhës dhe letërsisë. pdf</i>). Këto dokumenta administrohen nga vetë pedagogët, por periodikisht monitorohen dhe konfirmohen nga përgjegjësi i departamentit.			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga vizita në drejtorinë e burimeve njerëzore rezulton se administrohet dhe përditësohet me përpikmëri i gjithë informacioni, dokumentacioni dhe aktiviteti i të gjithë personelit të angazhuar, klasifikuar sipas kategorive përkatëse			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Për të intensifikuar komunikimin midis stafit dhe komunikimet student pedagogë janë bërë përpjekje për instalimin e programit Office 365 (<i>Shtojca 3.16-Model mësimi online.pdf</i>). Programi vlerësohet edhe si një mundësi e mirë për realizimin e mësimit online.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	U vizitua faqja e internetit (https://www.unkorce.edu.al/), informacioni gjendet në dy gjuhë, shqip dhe anglisht, por informacioni në gjuhën angleze nuk është i plotë (shembull- programet mësimore). Ndërkohë, GVJ konstatoi se faqja e internetit është e ndërtuar mbi një soft të vjetër dhe nuk i jep siguri përdoruesit të lundrojë në të.			
	<i>Nisur nga sa më sipër GVJ rekomandon:</i>			
	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Përditësimin e faqes zyrtare të internetit të UK në funksion të rritjes së sigurisë së shfrytëzimit të saj</i> • <i>Përmirësimin e përmbajtjes së informacionit në shërbim të studentëve</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, rezulton se buxheti i universitetit hartohet dhe miratohet duke filluar nga njësitë bazë, kryesore dhe ndihmëse të tij: Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria

<p>financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Financiare, të cilat kanë rregulloret e tyre të funksionimit (<i>Shtojcat 1.7; 1.8</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>UK ndjek procedurat e përcaktuara ligjore lidhur me hartimin e buxhetit (<i>Shtojca 1.8.1-Rregullorja financiare.pdf</i>) dhe ka struktura përgjegjëse për hartimin, zbatimin dhe auditimin e tij (<i>Shtojca 1.8-Rregullore e drejtorisë financiare.pdf; Shtojca 1.7-Rregullore e drejtorisë ekonomike.pdf</i>).</p> <p>Buxheti i institucionit miratohet nga Senati akademik dhe Bordi i administrimit të IAL (<i>Shtojca 3.15-Praktika e miratimit të buxhetit të UNIKO.pdf</i>). Realizimi i tij monitorohet periodikisht, po ashtu nga Senati dhe Bordi i administrimit të institucionit (<i>Shtojca 4.11-Të dhëna nga plani i financimit të programit të studimit.pdf</i>).</p> <p>Institucioni vë vënë në dispozicion "Të dhëna nga Plani i financimit të programit të studimit" (<i>Shtojca 4.11</i>), i cili është programi buxhetor vjetor dhe afatmësëm, 2021 - 2023, në relacionin shoqëruar jepet informacioni i detajuar mbi të ardhurat nga burime të ndryshme si nga pronësia, shërbimet administrative, shërbimet për të tretët, tarifat e studimeve në ciklet e ndryshme etj; kërkesat buxhetore për vitin 2021. Këtu përfshihen kërkesa si financimi i burimeve njerëzore, bursa, shpenzimet për mirëmbajtjen e mjediseve, pasurimin e literaturës, printimit, publikimeve, kërkimin shkencor etj</p> <p>Në fakt në këtë dokumentacion nuk del buxheti i përcaktuar për programin e studimit dhe për departamentin që e ofron.</p> <p>UNIKO i nënshtrohet auditimit financiar që realizohet nga Auditi i Brendshëm duke u bazuar në për caktimet e bëra në dokumentet e brendshme, si dhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Ky i fundit i bën publike rezultatet e auditit financiar.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Raportet e auditit shqyrtohen në Rektorat dhe Këshillin e Administrimit.</p> <p>UNIKO ka në strukturën e tij dhe degën e auditit, e cila planifikon plane auditimi.</p> <p>Bazuar në informacionin dhe dokumentacionin e siguruar nga institucioni, rezulton se raporti i veprimtarisë financiare diskutohet në organet kolegjiale dhe bëhet transparent për të gjithë stafin apo studentët e interesuar.</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Nga këto raporte ne të cila listohen dhe grantet e të ardhurat e buxhetit të këtij universiteti (<i>shtojca IV.11</i>). Vihet re se universiteti</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të</p>	<p>Nga këto raporte ne të cila listohen dhe grantet e të ardhurat e buxhetit të këtij universiteti (<i>shtojca IV.11</i>). Vihet re se universiteti</p>

programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	gjatë këtyre tre viteve ka realizuar një përqindje të lartë të kapacitetit të të ardhurave.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes së përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Niveli i përmbushjes së përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Politikat dhe procedurat për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit janë hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tjera nënligjore dhe rregulloret përkatëse (<i>Shtojca 2.2-Rregullore e njësisë kryesore , Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë. pdf</i>) përcaktojnë kriteret e përgjithshme të pranimit të studentëve në bazë të sistemit meritë-preferencë, në kuota të përcaktuara, dhe në koeficientët që aplikohen mbi bazën e arsimit që kanë kryer maurantët (gjimnaz i përgjithshëm, shkolla profesionale, etj.) dhe lëndët me zgjedhje. Programi mësimor Bsc në “Gjuhë-Letërsi” ka si kriter të veçantë pranimi vetëm, notën mesatare mbi 7.5. (<i>Shtojca 2.16-Praktika e miratimit të kriterëve të pranimit.pdf</i>). <i>Gjithsesi, vlen të përmendet numri i vogël i aplikimeve në këtë program studimi.</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. Në kriteret e pranimit janë parashikuar edhe regjistrimi i studentëve nga trojet shqipfolëse dhe të studentëve të huaj.
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeseshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret e pranimit, procedurat e përzgjedhjes së studentëve, procedurat e përparimit të studentëve gjatë kursit të studimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të studimeve, njohjes së studimeve të

<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>mëparshme të plota apo të pjesshëm, pasqyrohen në nenet përkatëse të rregullores respektive.</p>			
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>UNIKO ndjek me kujdes procedurat dhe informon palët e interesuara për të lehtësuar aplikimin e sistemit online të ministrisë, për maturën shtetërore. Proçesi i hyrjes në UNIKO menaxhohet nga Ministria e Arsimit nëpërmjet portalit të saj. Sistemi, siguron barazi midis studentëve, garanton konfidencialitet të informacionit, njoftime në kohë reale.</p> <p>Kriteret e pranimit të studentëve në UNIKO miratohen nga Senati Akademik (<i>Shtojca 2..16</i>)</p>			
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të MASR, të cilat miratohen nga Senati Akademik i UNIKO (<i>Shtojca 1.1 Satusi i UK</i>).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>UK shpërndan për studentët informacion të plotë në lidhje me përparimin e tyre akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve, kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit, etj. (<i>Shtojca 1.39 -Rregullore e Organizimit të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore të departamentit të gjuhë-letërsisë. pdf</i>) Falë adoptimit të sistemit ESSE3 (<i>Shtojca 1.6-Rregullore e ESSE3.pdf</i>) ka një menaxhim shumë të mirë të informacionit lidhur me çdo student për sa i takon krediteve, dhe kalimit në vitet pasardhëse, etj.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e</p>	

<p>njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Nga bisedat me studentët u konfirmua se niveli i ofrimit të shërbimeve dhe dokumentacioni që marrin nga sekretaritetë mësimore është i plotë. Studentët kishin informacion lidhur me format e kontrollit të dijeve si testimet ndërmjetëse, detyrat e kursit, ushtrimet në laborator, praktika profesionale apo provimet e formimit. Lidhur me këto detaje studentët informohen kryesisht nga pedagogët në orën e parë të modulit, por informacioni është gjithashtu i përhershëm në faqen ëeb të universitetit (www.unnikorce.edu.al).</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Studenti informohet për sa më sipër përmes burimeve të ndryshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Sistemit ESSE3 ➤ Programit të moduleve ➤ Komunikimit të pedagogut të modulit ➤ Portalit të UNIKO. 			
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit, përcaktohen procedurat e provimit të formimit, bazuar në programin e provimit të formimit, i cili u vihet në dispozicion studentëve përmes sekretarive përkatëse, në fillim të vitit akademik.</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Studenti përgatitet për provimin e formimit, bazuar në fondin e pyetjeve dhe lëndëve që përfshihen në provim dhe ka të renditur një listë me tituj të punëve kërkimore që mund të zgjedh (<i>Shtojca 2.14</i>). Në rastet e mbrojtjes së temave, studentit i vjen në ndihmë “udhëzuesi formati dhe kriteret e vlerësimit të punës kërkimore.. Shtojca .3.07) për punimin i cili është i vlefshëm për studentët e programit Bachelor, si dhe Master.</p> <p>Nga takimi me QKA u verifikuan aktivitetet e ndërmarra në kuadër të promovimit të programit të studimit në shkollat e mesme (<i>Shtojca II.13-Kalendari i veprimtarisë, "Dita e Informimi të Maturantëve".pdf</i>) ku janë shpërndarë material të ndryshme informuese. UK ka përgatitur një guidë të plotë të strukturës, programeve të studimit, shërbimeve dhe mundësive të punësimit të studentëve (<i>Shtojca 1.26</i>) Module orientuese për studentët drejt procesit dhe hyrjes dhe gjetjes së tregut të punës, Qendra e Formimit të vazhduar, që u bëhet prezent studentëve të rinj me fillimin e studimeve në këtë universitet.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-4342

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteret	Vlerësimi			
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>GVJ konstatoi se studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe se në dispozicion të tyre ka informacion të mjaftueshëm lidhur me objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit (Shtojca 2.2-Rregullore e njësisë bazë së gjuhë-letërsisë. pdf; Shtojca 2.5-Rregullorja e programit të studimit bachelor në Gjuhë-Letërsi.pdf). Funkcionimi i kërkesave të këtyre rregulloreve u konfirmua nga takimi me një grup studentësh të programit të studimit. Ndërkohë, planet mësimore u pa të ishin të afishuara në ambientet e UK dhe po ashtu, mund të shkarkoheshin në cdo kohë në faqe ëeb të universitetit. Sistemi ESSE3 i ka shërbyer shumë informimit të studentëve lidhur me të gjithë aspektet që kanë të bëjnë me modulet, kreditet, pagesat, etj.</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Studentëve u është shpërndarë informacioni i plotë mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit të mësimdhënies nëpërmjet orarit mësimor Studentët informohen për logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të procesit mësimor përmes sekretarive përkatëse Ky informacion u konfirmua nga studentët gjatë takimit që pati GVJ.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Nga vizita në zyrat e ndryshme, veçanërisht sekretarinë mësimore të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, u verifikuan format dhe dokumentacioni që shërben për informimin e studentëve lidhur me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. (Shtojca 1.10-Rregullore e sekretarisë mësimore.pdf).</p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Në funksion të informimit të studentëve për mundësitë e punësimit të tyre organizohet nga UK, respektivisht, Qendra e karrierës dhe alumni, edhe Panairi i karrierës së studentëve q; ka në fokus përditësimin e studentëve. (Shtojca 1.26, modulet orientuese për studentet drejt procesit të hyrjes në tregun e punës)</p>			
<p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>Institucioni disponon një sistem të menaxhimit të brendshëm në të cilin regjistrohet dhe arkivohet i gjithë informacioni në lidhje me studentët nga momenti i regjistrimit deri në marrjen e diplomës. Ky sistem menaxhimi ka të integruar sistemin ESSE3 për menaxhimin e mësimdhënies dhe shërbimeve drejtuar studentëve. Sistemi ESSE 3 u mundëson studentëve informacion mbi procesin mësimor në mënyrë lehtësisht të aksesueshme, madje edhe në distancë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p>Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimit në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</p>				

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>1.UNIKO dhe njësia bazë përkatëse për zhvillimin e programit të studimit disponojnë statistika të plota vjetore të studentëve, për numrin e studentëve dhe të diplomuarve (<i>Shtojca 1.01]-Tabela e të dhënave të regjistrimit dhe të ecurisë së studentëve në hyrje dhe në dalje.pdf</i>).</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020: 3 studentë; 2020-2021: 7 studentë; 2021-2022: 6 studentë.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>2.Të dhenat në FEF ruhen në regjistra të tri formave për studentët, paraprak, themeltar, të arritjeve të studentëve dhe regjistrin për lëshimn e diplomës. Këto të dhëna ruhen dhe përpunohen nga sekretariatë mësimore, sipas rregullores së Sekretarisë mësimore, [<i>Shtojca 1.10</i>].</p> <p>3.Departmenti analizon periodikisht performancën e studentëve në përfundim të cdo viti akademik, ku përfshihen analiza oër numrin e studentëve të regjistruar, c,regjistruar, sutdentë që fitojnë bursë, të diplomuar etj. Në mënyrë konstante, në të gjitha raportet e analizave vjetore pohohetnumri i ulët i studentëve dhe vështirësitë për tërheqjen e tyre ne kete program akademik.. Nga leximi i raportit të krijohet përshtypja se ka një qasje liberalizuese për vlerësimin e studentëve si mekanizëm për të rregulluar kalueshmërinë dhe se kalueshmëria e studentëve në mënyrë indirekte përdoret si kriter për vlerësimin e performancës së pedagogëve. Gjithsesi, në takimet me grupin e vlerësimit të brendshëm dhe stafin akademik të departamentit ky konstatim nuk u pranua të ishte i vërtetë.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>4.Sipas rregullores sekretaritë mësimore kanë për detyrë të zbatojnë plotësimin e evidencave standarde sipas kërkesave dhe afateve të kërkuara nga MAS apo UK. Hartohen raporte analitike mbi profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe dalje. Dy vitet e fundit dallohet kalueshmëri më e lartë, kjo edhe si rrjedhojë e cilësisë së studentëve të ardhur në këtë program akademik , si rrjedhojë e kriterit të mesates së vendosur nga ministria.</p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi, të cilat mund të gjenden në disa dokumenta si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Regjistri Themeltar i Studentëve, që është dokumenti që vërteton regjistrimin e studentëve në UNIKO. ➤ Rregjistri i arritjeve akademike është dokumenti që vërteton rezultatet e arritura nga çdo studenti regjistruar në UNIKO, sipas programeve t ë studimit. ➤ Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave, është dokumenti që vërteton diplomimin e tyre prej UNIKO. ➤ Regjistrat gjenden edhe në formë elektronike.
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	

Tendencat e ulëta të regjistrimit të studentëve në programin e studimit dhe ecuria e tyre githëvjetore kanë qënë subjekt i analizave të detajuara të departamentit (*Shtojca V.3-Analiza e të dhënave statistikore e njësisë bazë.pdf*).

Sekretaritetë mësimore plotësojnë evidenca standarde, që ruhet në sekretarinë mësimore. Fakulteti disponon regjistrin e arritjeve akademike dhe diplomave me të dhënat:

- Numri i diplomës
- Lista e notave

Këto të dhëna menaxhohen nga sistemi i brendshëm i informacionit të Sekretarisë së Fakultetit.

Informacioni në lidhje me diplomimin, listen e notave dhe suplementin e diplomës ruhet në regjistrin e arritjeve akademike dhe atë të diplomave, i cili, në përfundim të diplomimit, depozitohet në Arkivën e Shtetit dhe një kopje e njësuar meorigjinalin ruhet në arkivën e UNIKO-s.

Në takimin me sekretarinë mësimore u konstatua informacioni lidhur me regjistrimin, ecurinë dhe daljen e studentëve (*Shtojca 3.02-Regjistrimi i studentëve në hyrje.pdf; Shtojca 3.05-Regjistrimi dhe diplomimi i studentëve.pdf*) mblidhej, përpunohej dhe vihej periodikisht në dispozicion të departamentit (*Shtojca 1.10-Rregullore e sekretarisë mësimore.pdf*). U konfirmua gjithashtu se sistemi ESSE3 ofronte mundësinë e gjenerimit të raporteve jo vetëm për studentët e regjistruar, por edhe statistika për transferimet dhe largimet. ESSE3 konsiderohet të jetë i sigurt nga pikëpamja e ndërhyrjeve të paautorizuara dhe se informacioni është lehtësisht i verifikueshëm. Gjithashtu, rezulton se zyrat përkatëse kanë rregullore specifike lidhur me menaxhimin

Numri i transferimeve dhe largimeve nga programi i studimit bachelor është minimal.

Institucioni disponon një listë punësimi të studentëve të diplomuar, por prej saj nuk është e qartë se cilës periudhë diplomimi i takojnë. Për rrjedhojë *GVJ rekomandon përmirësimin dhe përditësimin e informacionit lidhur me punësimin e të diplomuarve të këtij programi specifik studimi.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi V.5



Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Pjesmarrja e studentëve në organet vendimmarrëse (Këshilli Studentor, Senat, Bordi i Administrimit dhe komisionet e përhershme) është në përputhje të plotë me ligjet dhe aktet e tjera nën ligjore (<i>Shtojca 1.1-Statuti i UK.pdf; Shtojca 1.07-Rregullore e këshillit studentor.pdf; Shtojca 1.19-Rregullorja FEF 1.27 .pdf</i>). Përfaqësimi i studentëve në të gjithë forumet vendimmarrëse u konfirmua edhe ne takimin me një grup studentësh të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Konfirmohet gjithashtu se aplikimi i sistemit ESSE3, ofron më shumë transparence në vlerësimin e studentëve. Në rregulloret e studimeve të të gjitha niveleve përshkruhet edhe procedurat e ankimimit, që në gjykimin e grupit të vlerësimit të jashtëm është e plotë dhe korrekte. Raportin vjetor të aktivitetit akademik të cilin UNIKO e paraqet pranë MAS, e publikon dhe ua bën të ditur stafit akademik, si dhe studentëve, me qëllim përfshirjen e tyre në analizë.</p> <p>Programi i studimit organizohet duke marrë në konsideratë aftësitë e studentëve për të përvetësuar sa më mirë njohuritë. Vlerësimi i ngarkesës akademike të studentit bëhet mbi bazën e informacionit teorik dhe praktik. Ngarkesa është e shpërndarë në mënyrë të përbalueshme në semestra gjatë ciklit të studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>UK ka si objektiv plotësimin e standarteve lidhur me ngarkesën mësimore të studentëve por dokumentimi i përfshirjes së studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit nuk është i plotë. Vetë raporti i vlerësimit të brendshëm pranon se angazhimi real i studentëve në procesin e vendim marrjes në UK nuk është në lartësinë e duhur.</p> <p>Departamenti kryen anketime të studentëve për marrjen e opinionit të tyre mbi ngarkesën akademike dhe mësimore. Gjithashtu në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, organizohet pyetëtori studentor për cilësinë e mësimdhënies për modulet e çdo programi studimi, si dhe pyetëtori online për vlerësimin e aktivitetit mësimore</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Departamenti kryen anketime të studentëve për marrjen e opinionit të tyre mbi ngarkesën akademike dhe mësimore. Gjithashtu në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, organizohet pyetëtori studentor për cilësinë e mësimdhënies për modulet e çdo programi studimi, si dhe pyetëtori online për vlerësimin e aktivitetit mësimore</p> <p>kërkimor ku vlerësohet edhe puna e strukturave ndihmëse (<i>Shtojca 3.02]-raporte dhe analiza të departamentit</i>).</p> <p>UNIKO ka hartuar një sërë dokumentesh që mundësojnë siguriminë barazisë, vlerësimit dhe kontrollit, si regjistri fizik, pasqyra e vlerësimit të studentit, hedhja e të dhënave për vlerësimin e studentit në sistemin ESSE3, ku student para hyrjes në provim mund të shikojë vlerësimin gjatë vitit, procedura e ankimimit. Në rastet e ankimimit, procedura, si dhe vendimi i marrë regjistrohen në regjistrin e ankesa vetë studentëve që mbahet në Dekanat.</p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit,</p>	<p>Sistemi është i tillë që për çdo ndërhyrje lihet gjurmë për kohën, apo edhe numrin serial të kompjuterit ku është hedhur vlerësimi. Pas periudhës së parashikuar në rregullore, sistemi nuk lejon ndërhyrje pa një procedurë të veçantë të parashikuar në manualin dhe rregulloret e Universitetit.</p>

rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.6	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve. UNIKO ka njësinë e informimit të studentëve, Zyrën e informimit dhe Orientimit të studentëve, e cila orienton të rinjtë sipas nevojave të tyre. Në funksion të studentëve është QKA e cila asiston dhe ndjek studentët edhe pas kohës së studimeve.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	UNIKO ka në dispozicion të studentëve faqen e ëeb-it të UNIKO-s e cila është e aksesueshme nga të gjithë në cdo kohë. Vendimet e Senatit Akademik, Bordit të Administrimit, Rektorati dhe Dekanati në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor, të studentëve, rezultatete analizave të bëra, etj., u bëhen me dije studentëve në formatë ndryshme si takime të drejtpërdrejta me studentët, shpalljeve në mjediset e caktuara të Universitetit, njoftimeve në faqen elektronike etj
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Në UK është ngritur dhe funksionon Qendra e Karrierës dhe Alumni. Qendra funksionon në kuadër të sektorit të kurrikulave dhe sigurimit të cilësisë (<i>Shtojca 1.4-Rregullore e drejtorisë së burimeve njerëzore.pdf</i>). UNIKO u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës, përmes Qendrës së Karrierës dhe Alumni e cila ka ndërtuar një bazë të dhënash të studentëve që diplomohen në UNIKO, me synim ndjekjen e punësimit të tyre deri në pesë vjet (<i>Shtojca 5.03</i>). Qendra është e pajisur me stafin dhe facilitetet e nevojshme. Studentët orientohen lidhur me procesin mësimor, zgjedhjen dhe orientimin e praktikës profesionale dhe veçanërisht orientimin në tregun e punës. Qendra përgatit material informuese për studentët e rinj dhe i orienton ata për mundësitë e transferimit të krediteve të studimit, apo transferimit të programeve të studimit, si edhe për mundësitë e kryerjes së praktikave profesionale dhe të punësimit.
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të	

dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	<p>Informimit të studentëve për mundësitë e punësimit i shërben organizimi i përvitshëm i panairëve të karrierës.</p> <p>Qendra e karrierës dhe alumni kanë ndërtuar një bazë të dhënash të studentëve që diplomohen në UK, me synim ndjekjen e punësimit të tyre deri në 5 vjet, por ndërtimi i portalit interaktiv të QKA është në fazat fillestare.</p> <p>Dokumente të tilla si, regjistri i pedagogut, pasqyra e vlerësimit të të dhënave, dhe procedura e ankimit, e cila nga intervistat me studentët rezultoi funksionale, bëjnë të mundur rritjen e cilësisë dhe ndihmesë të plotë në funksion të çështjeve shqetësuese për studentët.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UK ka hartuar dhe miratuar një seri dokumentesh në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 datë 22.7.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Kodit të Cilësisë si dhe një sërë strukturash për sigurimin e cilësisë. UNIKO harton politikat dhe procedurat, referuar cilësisë identifikojmë, manualin e cilësisë (<i>Shtojca 1.16</i>), si dhe standarti për sigurimin e brendshëm të cilësisë (<i>Shtojca 1.1; 12</i>), të cilat miratohen nga organet kolegjiale. Manuali miratohet drejtpërdrejtë nga Rektori. UNIKO ka hartuar një plan strategjik 4 vjeçar (<i>Shtojca 1.3</i>) ku përshkruhen politikat dhe praktikat që ndjek ky institucion. Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor janë objektiva të shprehura qartë në Statutin dhe rregulloren e institucionit (<i>Shtojca 1.1-Statuti I UK.pdf; Shtojca 1.2-Rregullorja e UK.pdf</i>) dhe konfirmohen në planin strategjik të këtij institucioni për
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe	

bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	<p>periudhën 2016-2020 (<i>Shtojca 1.3-Plani strategjik UNIKO 2016-2020.pdf</i>).</p> <p>UK ka hartuar dhe miratuar gjithashtu manualin e cilësisë (<i>Shtojca 1.16-Manual i cilësisë UK 2020.pdf</i>), që përcakton parimet dhe strukturat përgjegjëse të sigurimit të cilësisë në institucion.</p> <p>Në institucion rol thelbësor ka dhe Drejtoria e kurrikulave, sigurisë së cilësisë dhe kërkimit shkencor, në përbërje të të cilës është: Sektori i kurrikulave dhe sigurimit të cilësisë (<i>Shtojca 1.5-Rregullore e drejtorisë së kurrikulave (NjsBC, QKA).pdf</i>). Në përbërje të sektorit në fjalë, funksionon Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë (NjsBC) që ka përfaqësues nga cdo njësi kryesore (<i>Shtojca 3.07-Të dhëna për NjsBC.pdf</i>). Në Fakultetin e bujqësisë është ngritur dhe funksionon Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë, që funksionon në përputhje me Rregulloren e Fakultetit të bujqësisë (<i>Shtojca 2.2-Rregullore e njësisë bazë agronomi.pdf</i>).</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Strukturat e ngritura janë funksionale. Grupi i vletërimit të jashtëm u njoh me një raport të detajuar NJSBC të Fakultetit të Gjuhës Letërsisë për vitin akademik 2020 -2021. (<i>RVB. Ba, GJL 2020 – 2021.pdf</i>.) Sigurimi i cilësisë në mësimdhënie dhe i përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulave ka qenë objekt i përhershëm i aktivitetit dhe analizave vjetore të Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë. (<i>Shtojca 3.8-Analiza vjetore e njësisë bazë.pdf</i>; <i>Shtojca 3.02-. Ndërkohë, programi i studimit bachelor në “gjuhë dhe letërsi” është në proces të vlerësimit të jashtëm nga ASCAL.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Gjithsesi, GVJ nënvizon se kalueshmëria e përvitshme 100% në dhe numri i pakët i studentëve, ngre dyshime për vlerësime fiktive të studentëve. Ndërkohë, nuk ka informacion që të dëshmojë se në institucion të jenë diskutuar raste apo ndërmarë masa përkundrejt rasteve të mundshme të notave të pamerituara.</p> <p>Sektori i kurrikulave dhe sigurimit të cilësisë, monitoron analizat dhe vlerësimin e proceseve akademike që kontrollohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve përkatëse. Gjithashtu, kjo zyrë përgatit në mënyrë të përvitshme analizën e veprimtarisë mësimore të Universitetit dhe ia referon atë Senatit Akademik.</p> <p>Në përfundim të analizave reflektohet me rekomandime dhe detyra për procesin mësimor, cilësinë e mësidhënies dhe propozohen masa përmirësuese.</p> <p>Në fund të çdo viti akademik organizohet rishikim periodik i programit të studimit dhe rregullores mësimore të tij, ku fokusi kryesor janë elementët përbërës të moduleve dhe kreditet, baza e nevojshme didaktike për realizimin e programit të studimit, literatura e përdorur, procedurat e kontrollit të dijeve/provimeve dhe analizës së rezultateve të kontrollit. Gjatë këtij merret në konsideratë dhe mendimet e studentëve përmes anketimeve që kryhen.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.2
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënësve

Kriteret	Vlerësimi								
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	Sektori i kurrikulave dhe sigurimit të cilësisë në përbërje të drejtorisë së kurrikulave, sigurisë së cilësisë dhe kërkimit shkencor (<i>Shtojca 1.5-Rregullore e drejtorisë së kurrikulave (NjSBC, QKA).pdf</i>) është përgjegjës për vlerësimin dhe përmirësimin periodik të kurrikulave. Ndryshimet e kurrikulës së programit të studimit realizohen sipas një procedure, të përcaktuar në manualin e cilësisë së UK (<i>Shtojca 1.16-Manuali i cilësisë UK.pdf</i>). Grupi i ekspertëve të jashtëm u njoh me praktikën konkrete të ndryshimeve në programin e studimit bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi" (<i>Shtojca 2.11-Procedura e ndryshimit në planin mësimor për vitin 2021-2024.pdf</i>). Ndryshimet e bëra dhe procedura e ndjekur ruhen në dosjet përkatëse të arkivës së UK.								
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe të ngarkuar rezultoni se institucioni përdor procedura të dokumentuara për shqyrtimin dhe miratimin e programeve të studimit, si dhe për mbikëqyrjen e here pas here të programeve të studimit. (<i>Shtojca 2.11</i>). Instrumentat e përdorur për vlerësimin e cilësisë janë përmendur dhe më sipër. Ato përfshijnë anketimet dhe pyetësorët e studentëve në përfundim të çdo semestri (<i>Shtojca 3.01</i>) për programin e studimit, për performancën e stafit akademik, etj.								
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Bazuar në raportin përmbledhës të pyetësorit studentor (<i>Dokumenti shtesë 3</i>), 57.6% e numrit të studentëve që kanë marrë pjesë gjykojnë se në programin e studimit bachelor në "Gjuhë Letërsi" ka lëndë të papërshtatshme.								
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	<i>Megjithatë, GVJ ashtu si edhe hartuesit e këtij raporti gjykon se pjesëmarrja shume e ulët e studentëve në këtë anketim (vetëm 6% e totalit të tyre) e bën pak të besueshëm këtë gjykim.</i>								
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.									
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.3
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë	Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë (NJSBC) me përfaqësues nga çdo njësi kryesore është përgjegjëse për vlerësimin e programeve të studimit (<i>Shtojca III.02-Raporte vjetore për departamentin</i>

<p>periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p><i>dhëna për NJSBC.pdf</i>). Vlerësimet bëhen në përputhje me kriteret, kërkesat dhe procedurat e parashikuara në manualin e cilësisë (<i>Shtojca 1.16-Manual i cilësisë UK 2020.pdf</i>)</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Në këtë fakultet është ngritur dhe funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila në fund të vitit akademik harton raportin përkatës (<i>Shtojca III.02 -Raport vjetor i NJSBC.pdf</i>). Vlerësimi i cilësisë së programit të studimit dhe i cilësisë së mësimit kanë qenë objekt konstant i analizave vjetore të Departamentit të gjuhë letërsisë. (<i>Shtojca 3.02-Analiza vjetore e njësisë bazë.pdf</i>) dhe analizave vjetore të institucionit (<i>Shtojca 3.29-Analiza vjetore e UNIKO.pdf</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Vlerësimi institucional i realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit dominohet nga metodat të drejtpërdrejta të vlerësimit. Vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim dhe përmirësimi periodik i kurrikulës, analiza e procesit të mëimdhënies dhe e rezultateve të studentëve, apo analiza periodike e efektivitetit të praktikave mësimore dhe profesionale të studentëve janë objekte të përhershme të analizave vjetore të departamentit përgjegjës për programin mësimor dhe vetë njësisë kryesore, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që</p>	<p>Vlerësimet paralele ekzistojnë gjithashtu si praktikë, por ato janë parashikuar dhe ndodhin në rastet kur studentët kanë reklamim për vlerësimin e kryer nga pedagogu përkatës. Institucioni ka bërë përpjekje për vlerësimin e cilësisë dhe ecurisë së programit edhe nëpërmjet metodave të tërthorta, ku thelbësor është anketimi periodik i studentëve.</p> <p>Gjithsesi, ashtu si është nënvizuar në këtë raport pjesëmarrja e studentëve në këto anketime ka qenë e ulët. Ndërkohë, nuk është i dokumentuar tërheqja e mendimit të institucioneve që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. Në takimin me studentët u informuam se ata ishin në dijeni dhe pjesëmarrës së pyetësorëve të hartuar nga SKSC, (<i>shtojca III.01</i>).</p> <p>Gjithsesingja stafi akademik u shpreh shqetësimi se ZVA edhe pse është institucion bashkëpunës, për këtë periudhë nuk një nuk ofronte vende të lira pune për mësues. Departamenti kryen analizën me Qendrën e Karrierës dhe Alumnit (<i>shtojca .1.43</i>) në të cilën identifikohet edhe numri i të punësuarve nga ky program studimi dhe mundësitë e promovimit të këtij programi dhe pyetësor që në thelb sesa i nevojshëm dhe sa ndihmues ka qenë ky program studimi për karrierën e tyre.</p>

përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	UK përmbush këtë standard, nëpërmjet përfshirjes së njësisë akademike, personelit dhe studentëve në proceset e SBC-së së programeve të studimit dhe informimit të palëve të interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra. GVJ konstatoi praninë e strukturave të posaçme për sigurimin e cilësisë dhe shfrytëzimin prej tyre të manualit të cilësisë, rregulloreve dhe udhëzimeve përkatëse (<i>Shtojca 1.5-Rregullore e drejtorisë së kurrikulave (NJSBC, QKA).pdf; Shtojca 1.16-Manual i cilësisë UK 2020.pdf</i>).
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Në rregulloren e përgjithshme , në rregulloren e Fakultetit, dhe në manualin e sigurimit të cilësisë specifikohen detyrat dhe modalitetet e angazhimit të strukturave të ndryshme të të gjitha niveleve. Përfshirja e Departamentit të Gjuhë-Letërsisë dhe të Fakultetit materializohet në raportet respektive vjetore.
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.	GVJ konstatoi angazhimin e plotë të personelit akademik dhe ndihmës-akademik të njësisë bazë dhe njësisë kryesore në diskutimet për sigurimin e cilësisë së programit. Ata kanë qenë pjesë e vlerësimit të cilësisë së programit të studimit nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në mbledhjet e departamentit dhe Fakultetit, apo përgjigjeve ndaj pyetësorëve që adresojnë çështje të vlerësimit të brendshëm të programit të studimit.
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të	GVJ konfirmon gjithashtu pjesëmarrjen e studentëve të programit të studimit në vlerësimin e brendshëm të cilësisë tij. Praktikisht studentët janë pjesë e qeverisjes së Universitetit të Korcës, nëpërmjet prezencës së përfaqësuesve të tyre në Senat, Komisionin e përhershëm për

respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	sigurimin e standarteve të cilësisë, Këshillin studentor dhe komisionin e etikës. Paralelisht me këtë, studentët shprehin opinionet e tyre edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet angazhimit periodik në anketimet studentore.			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Ndonëse pohohet dobia që sjell, GVJ nuk mundi të dokumentojë përfshirja e bashkëpunëtorëve dhe/ose ekspertëve të jashtëm në sigurimin e cilësisë së programit dhe përmirësimin e tij. Vlerësimi i brendshëm i cilësisë së programit dhe performancës e pedagogëve është një proces tërësisht ligjor dhe që respekton maksimum integritetin njerëzor dhe akademik të çdo individi dhe shmang maksimalisht çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt stafit akademik e jo akademik dhe studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politikat, proceset dhe veprimtaritë për sigurimin e brendshëm të cilësisë për programin e studimit janë publike,) bëhen publike dhe janë të aksesueshme nga i gjithë stafi akademik dhe ai ndihmës akademik i UNIKO, përfshirë këtu edhe studentët. Departamenti i Gjuhë - Letrësisë diskuton dhe analizon veprimtarinë mësimore dhe kërkimore-shkencore, (Shtojca III.02), ku në raportin e hartuar jepen edhe rekomandimet përsa i përket përmirësimin të cilësisë. Masat, që synojnë përmirësimin e elementëve të identifikuar për të reflektuar, dokumentohen në formën e planeve të masave me qëllim sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë. Në zbatim të këtyre rekomandimeve ngarkohet për zbatim stafi akademik dhe ai ndihmës akademik. Studentët, stafi akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, informohen dhe ndërgjegjësohen në mënyrë të vazhduar për rëndësinë e sigurimit dhe përmirësimin të cilësisë.
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	

<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Mbledhjet e departamentit, shërbejnë për njohjen me arritjet, mangësitë, problematikat dhe praktikat lidhur me sigurimin e cilësisë në procesin e mësimdhënies dhe të veprimtarisë kërkimore-shkencore</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>U konfirmua prezenca e një sërë raportesh nga struktura përgjegjëse për sigurimin e cilësisë; raporte të analizës vjetore të njësisë bazë (Shtojca 3.8) dhe raport i NJSBC për vitin akademik 2018-2019 (Shtojca 3.7). Në raportet e analizave vjetore janë dikutuar gjetjet e strukturave të sigurimit të cilësisë dhe janë parashikuar masa për përmirësimin e problematikës së vërejtur lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Gjuhë – Letërsi” i Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë.

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit trashëgon eksperiencën e programit tradicional dhe ka vazhdimësi në programin e ciklit të dytë dhe ka përputhje të plotë me fushën akademike dhe shkencore të FEF.
2. Stafi akademik zotëron kompetenca të shumëllojshme dhe ka kualifikim të lartë akademik.
3. Struktura përgjegjëse për realizimin e programit bën përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e kurrikulës me nevojat dinamike të tregut të punës.

Pika të dobëta

1. Preferencë e ulët e të rinjve për të studiuar programin Bachelor në Gjuhë – Letërsi dhe për t'u angazhuar në aktivitete. Universitetet e tjera në zona të afërta gjeografike ofrojnë programe të njëjta/të ngjashme studimi që mund të ndikojnë në uljen ndjeshëm të numrit të studentëve.
2. Nivel i ulët i punësimit të të diplomuarve në vende pune që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me programin e studimit.
3. Konkurrencë e fortë nga programe të tjera studimi, më të pëlqyeshme midis të rinjve, të ofruara nga vetë Universiteti i Korçës.
4. Mungesa e përfshirjes në projekte kombëtare dhe ndëkombetare.

Rekomandime

1. Të rrisë mbështetjen financiare për departamentin e Gjuhë - Letërsisë në funksion të thellimit të aktivitetit të tij kërkimor dhe paralelisht me të, nxitjen dhe promovimin e publikimeve të stafit akademik në periodikë shkencorë të listuara në database të identifikuar për thellësinë dhe seriozitetin e kërkimit shkencor.
2. Rritjen e efektivitetit të laboratorëve didaktikë-shkencorë në përgjithësi dhe funksionalizimin e pajisjeve moderne që egzistojnë në disa prej këtyre laboratorëve në veçanti.
3. Pasurimin e bibliotekës së UK-së dhe bibliotekës së FEF me tituj librash të rinj, sidomos në gjuhë të huaj, si dhe zgjerimin e aksesit në burimet online të literaturës bashkëkohore jo vetëm me tituj fizik, por edhe me shtimin e mundësive për të qenë pjesë e bibliotekave online të universiteteve prestigjioze.
4. Rekrutimin e stafit të ri akademik me kohë të plotë ose të pjeshme për të ulur ngarkesën në mësim të stafit egzistues.
5. Përditësimin e faqes zyrtare të internetit të UK-së në funksion të rritjes së sigurisë së shfrytëzimit të saj dhe përmirësimin e përmbajtjes së informacionit në shërbim të studentëve, sidomos për sa i takon informacionit që ofrohet në gjuhën angleze.

6. Zgjerimin e kontakteve me institucione publike e jo publike, biznese, në funksion të zgjerimit të mundësive për aftësim të vazhdueshëm të studentëve, përditësimin dhe përmirësimin e studimeve për tregun e punës.
7. Bashkëpunim më të thelluar me departamentet simotra në universitete në të gjithë hapësirën shqipfolëse, si dhe me katedrat e albanologjisë jashtë vendit.
8. Të punohet për ndërkombëtarizimin e departamentit, për të integruar dhe shfrytëzuar me dinamikizëm kapacitet akademike, si dhe për kontakte në përputhje me zhvillimin e rajonit dhe me elemente të globale me rikonceptim dhe rivlerësim të vlerave tona kombëtare.
9. Të shtojë përpjekjet për hapjen e programeve të përbashkëta me universitete të huaja, në dobi të prirjeve bashkëkohore që arsimit i lartë ka sot në Republikën e Shqipërisë, për zhvillime të reja dhe konkrete, për mundësi zhvillimi dhe rritjen e ofertës së punësimit për studentëve.
10. Të shikohet mundësia e ngritjes së një Bordi Këshillimor me partnerë strategjikë për tregun e punës në nivel fakulteti.

Conclusions of the study program Evaluation of the first cycle Bachelor in "Language - Literature" of the Institution of Higher Education University "Fan S. Noli", Korça.

Strengths and affirmations:


1. The study program inherits the experience of the traditional program and has continuity in the second cycle program and is in full compliance with the academic and scientific field of FEF.
2. The academic staff possesses various competencies and has a high academic qualification.
3. The structure responsible for the implementation of the program makes continuous efforts to improve the curriculum with the dynamic needs of the labor market.

Weak points

1. Low preference of young people to study the Bachelor program in Language - Literature and to engage in activities. Other universities in close geographical areas offer the same / similar study programs that can significantly reduce the number of students.
2. Low level of employment of graduates in jobs directly related to the study program.
3. Strong competition from other study programs, more popular among young people, offered by the University of Korça itself.
4. Lack of involvement in national and international projects.

Recommendations

1. To increase the financial support for the Department of Language and Literature in order to deepen its research activity and in parallel with it, to encourage and promote the publications of the academic staff in scientific periodicals listed in databases identified for the depth and seriousness of scientific research.
2. Increasing the effectiveness of didactic-scientific laboratories in general and the functioning of modern equipment that exists in some of these laboratories in particular.
3. Enriching the UK library and the FEF library with new book titles, especially in foreign languages, as well as expanding access to online sources of contemporary literature not only with physical titles, but also with increasing opportunities for it have been part of the online libraries of prestigious universities.
4. Recruit new full-time or part-time academic staff to reduce the teaching load of existing staff.
5. Updating the official website of the UK in order to increase the security of its use and improve the content of information in the service of students, especially in terms of information provided in English.
6. Expanding contacts with public and non-public institutions, businesses, in order to expand opportunities for continuous training of students, updating and improving studies for the labor market.
7. Deeper cooperation with similiar departments in universities throughout the Albanian-speaking area, as well as with the departments of Albanology abroad.
8. To work for the internationalization of the department, to integrate and dynamically use the academic capacity, as well as for contacts in accordance with the development of the region and with global elements with reconceptualization and re-evaluation of our national values.
9. To increase the efforts for the opening of joint programs with foreign universities, for the benefit of the contemporary tendencies that higher education has today in the Republic of Albania, for new and concrete developments, for development opportunities and increase of the employment offer for students.
10. Consider setting up an Advisory Board with strategic labor market partners at the faculty level.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Plotësisht	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

